

KOSOVARJA

Ballina: Ilir dhe Vjollca Sinani
Foto: Veton Osmani

Si ecte
gjaku
i të vrarëve
në Nishevc

Cili shqiptar
mbajti burg
më shumë
se Adem Demaçi

Familja Stafa
artistë të njohur

ILIR&VJOLLCA SINANI

*shembull për biznes, humanitet,
jetë të rehatshme familjare*


Inxhinierja
Albulena Dakaj
e suksesshmja
në Suedi

Sa herë
putheshim
thoshim
“lamtumirë”

Çfarë dashurie
kanë VIP-at tanë

Një dreq ndërmjet
meje dhe vjehrrës

Kosovarët paraqiten
“homoseksualë”
që të fitojnë azilin





DINO COMPANY

MAGJISTRALJA PRISHTINE-FERIZAJ km-2, 14000 LIPJAN, KOSOVË

+383 44 206 586

www.dino-company.com

Dino keramika, është kompani e cila ofron produkte me shumice dhe pakicë, nje game të gjere të llojeve të keramikës të cilat vijnë nga fabrikat me të njohura italiane dhe spanjolle ; "mirage", "azuvi", "ecoceramic"

Strukturë dhe ngjyrë të veçantë, efekte që kënaq shijet dhe nevojat estetike, kombinime të koordinuara, kontraste dhe përshtatje.



NUK LËSHOJNË
KOMPONENTE
TË DËMSHME

ARMIQ
NDAJ
BAKTERIEVE

NUK
PËRBEJNË
ALERGJI

PASTROHEN
LEHTË

NUK LËSHOJNË
KOMPONENTE
TË DËMSHME



info@brezovicahotel.com
www.brezovicahotel.com



Edhe në pandemi mësimi disi vazhdoi...

Ka dy vjet që nuk ka më mbrëmje të maturës, shkaku i pandemisë. Pra, nuk ka zhurmë dhe eufori të mbrëmjeve të maturës, siç ka ndodhur në të kaluarën, kur maturantët kanë përjetuar momentet magjike të mbrëmjes së shumëpritur. Por, edhe në këtë kohë pandemie, shumë të rinj e të reja po jetojnë mes dilemash dhe zgjedhjes së profesionit të ardhshëm. Ku, si, qysh? - Flasin disa prej tyre...

**JON BYTYÇI:
SYNIM KAM
UNIVERSITETIN
SHTETËROR**

- Vërtet, matura sa është e mirë aq është edhe e vështirë. Ne, si maturant, që nga fillimi i vitit të sivjetmë shkollor, ku herë shkonim në shkollë e herë mësimin e ndiqnim online, asnjëherë nuk kemi qenë të qetë. Sepse, testi i maturës të kufizon në zgjedhjen e profesionit të dëshiruar. Synim kam Universitetin Shtetëror. Dua të regjistrohem në arkitekturë. Dashtë Zoti e t'ia dal, përndryshe s'di ku të orientohej tjetër...

**ARLINDA DERVISHI:
DUA TË BËHEM DIZAJ-
NERE E MODËS**

- Kam shumë plane pas maturës, por më e rëndësishmja është kalueshmëria në testin e maturës shtetërore, e që nuk di a do të organizohet sivjet shkaku i pandemisë. Them më e rëndësishmja, sepse nga pikët që do i marrë varet se a do të mund të regjistrohem në Universitet. Dua të bëhem dizajnere e modës, andaj di që më pret një rrugë e gjatë dhe me shumë sfida.

**VISARE DËRGUTI:
DO MENDOJ MIRË
PËR T'U BËRË MIRË...**

- Pas maturës kam shumë ëndrra: dëshiroj të regjistrohem në Universitet, të kem rezultate, të njoh njerëz të rinj dhe të punësohem. Dua të besoj se gjërat do të

shkojnë mirë, pasi thonë: "Mendo mirë për t'u bërë mirë".

**ALTIN RAMUSHI:
SË PARI DO TË PUNOJ
KAMERIER, PASTAJ NJË
ZOT E DI...**

- Meqë viti shkollor veç po kryhet, e edhe masat ndaj pandemisë kanë filluar të largohen, së pari do të kërkoj punë, sepse materialisht në familje i kemi kushtet keq, meqë jetojmë vetëm nga pensioni që merr babai e nëna, madje pension moshe...

Pra, edhe unë kam dëshirë të studioj si shokët e mi, por s'kam mundësi për një gjë të tillë. Dashtë Zoti të gjej punë dhe pastaj, ndoshta, pas një viti do të mund edhe të studioj.

Tash për tash, për mua është shumë e rëndësishme t'ia dal në ndihmë familjes, e cila më ka ndihmuar shumë që ta përfundoj shkollën e mesme pa më munguar asgjë.

PËR FUND

Edhe sivjet, si dhe viti i kaluar, për nxënësit që një vit i vështirë shkollor: një javë në mësim - një javë në shtëpi duke ndjekur mësimin online. Herë-herë edhe duke mos shkuar nga dy javë në mësim, kur është paraqitur në klasë ndonjë nxënësi me Covid, apo edhe duke u mbyllur e tërë shkolla kur profesorët kanë qenë të prekur nga Covid.

Por, edhe ky vit shkollor kaloi, e dashtë Zoti viti tjetër të shkojë mirë e mbarë...

Diturie Haxhaj

Nuk është hera e parë që emri i Ilir Sinanit përmendet për të mirë, për sukseset në punë, për të arriturat e firmës së tij të njohur në Gjermani, “Sinani GmbH & Co.Kg”.

Është nga ata biznesmenë që vizionet i ka të qarta, që punon si një gjerman, ndërkohë është një shqiptar i denjë.

I ecë biznesi mirë, por ka edhe rehati e qetësi familjare...

Në këtë numër të “Kosovares” flasim me çiftin Ilir e Vjollca Sinani. Me Ilirin shpallim për gjërat e jetës, sukseset, por edhe anën e tij humanitare.

Ndërkaq, Vjollca e plotëson bisedën, duke treguar anën tjetër të biznesmenit të njohur...



Ilir dhe Vjollca Sinani, shembull për biznes, humanitet, jetë të rehatshme familjare

**ILIR SINANI,
BIZNESMENI,
HUMANISTI
DHE PATRIOTI I MADH**

I lindur në fshatin Celinë të Rahovecit, nga vendlindja është larguar në kohën e represionit serb. Thotë se e kishte shumë vështirë të largohej nga Kosova, nga familja e të afërmit...

“Pa dyshim, fillimi në një vend të huaj ka qenë i vështirë”, thotë Iliri, i cili me modesti tregon se në fillimet e tij në kurbet kishte

punuar disa vjet në një furrë buke. “Pastaj, i kam kryer disa kurse dhe seminare dhe kam kaluar me punë në një kompani për rregullimin e rrugëve”, shton ai. Por, fati thonë se është në anën e atyre që punojnë dhe nuk ndalen. Ashtu edhe është. Sot ai është pronar i një kompanie të suksesshme në Gjermani. “Jam pronar i kompanisë sime, “Sinani GmbH & Co.Kg”, e cila i ka mbi 40 punëtorë dhe të gjithë janë shqiptarë. Dhe, jo vetëm shqiptarë nga Kosova, por nga të gjitha trojet shqiptare. Sepse, në këtë mënyrë, dua ta ndihmoj kombin tim

aq sa mundem.

Me krenari them se ne, shqiptarët, jemi punëtorë të palodhshëm dhe për këtë na e kanë lakmi të tjerët”, tha në vazhdim të bisedës sonë Iliri.

Sidoqoftë, thujse të gjithë e dinë se Ilir Sinani është shumë i suksesshëm në fushën e biznesit, por edhe njeri me zemër të madhe, humanitar dhe një nga përfaqësuesit dhe donatorët e Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”.

“Humanizmi është i mirë çdoherë dhe kudo që e lypë nevoja. Më parë kam marrë pjesë në shumë iniciativa bamirësie të shokëve, miqve dhe të tjerëve dhe kam parë se sa gjë e mirë është t’i ndihmohet njerëzit që kanë nevojë, që presin t’i ndihmohet. Dhe, më ka bërë përshtypje mënyra si i ndihmojnë...”

Pastaj, kam filluar edhe vetë t’i ndihmoj ata që kanë nevojë. Në këtë drejtim më ka shërbyer, si shembull, Halil Kastrati, e që për mua është njeri i mirë, e çmoj dhe meriton respekt të përgjithshëm. Kështu, edhe jam kyçur në Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”.

Më pastaj, më kanë caktuar përfaqësues për Gjermani dhe e kemi hapur xhirollogarinë në Gjermani, ku njerëzit e vullnetit të mirë dhe donatorët e kanë më lehtë t’i deponojnë të hollat që i japin për bamirësi”, thotë Iliri, teksa flet për ndihmat humanitare.

Pa dyshim, biznesmeni, Ilir Sinani, kontribuon fuqishëm edhe në fushën kombëtare e kulturore...

“Aktivitete kulturore-kombëtare e sportive kemi shumë dhe është e pamundur t’i

përmendim të gjitha në një shkrim.

I kam përkrahur humoristët, Qumilin dhe Cimën, në 4 komedi. E kam përkrahur Konsullatën Shqiptare për 105-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, kemi organizuar me Lulzim Maliqin, Agron Muharremin dhe Klubin Futbollistik “Kosova” koncert, në të cilin kanë marrë pjesë shumë artistë tanë dhe e kemi ftuar Klubin e Futbollit nga Tërnoci në një ndeshje vëllezërore futbollit.

Me këtë rast, synimi kryesor ishte bashkimi i shqiptarëve nga Kosova Lindore me Kosovën Qendrore. Me ç’rast u organizua një manifestim madhështor, në të cilin morën pjesë shumë bashkatdhetarë tanë që jetojnë në Zvicër, por edhe në shtetet përreth”.

Dhe, pa dyshim, kur e dëgjon Ilir Sinanin teksa flet për ato që bënë, të vjen ta duar-trokasësh...

“Diaspora shqiptare para, gjatë dhe paslufte ka qenë shtylla kryesore e Kosovës. Por, megjithatë, sa u përket investimeve, mendoj se nuk jemi të informuar sa duhet dhe si duhet...”

E, pse? Këtë nuk e di!”, thotë Iliri, të cilin edhe e pyetëm a mendon të investojë në vendlindje...

“Unë, vazhdimisht, jam i preokupuar se si të investoj në Kosovë. Natyrisht, jo të përfitoj, por t’u mundësoj punësim të rinjve të Kosovës, të cilët, në pamundësi punësimi, shëtisin poshtë e lart ose e kalojnë kohën në restorante e në tym duhanit...”

E, a do të mund t’i realizoj synimet e mia, do të tregojë koha...”, thotë biznesmeni, humanisti, patrioti dhe babai i pesë fëmijëve, Ilir Sinani.

Sidoqoftë, vlen të përmendet se Ilir Sinani, kohë më parë, hapi Marketin “Molla”, në qytetin Haag në Oberbayern të Gjermanisë, i cili është i furnizuar me produkte ushqimore të Kosovës.

Po ashtu, të njëjtin market e hapi edhe në qytetin Mynih.

Andaj, bashkatdhetarët tanë më nuk kanë nevojë t’i bartin gjërat ushqimore të Kosovës për në Gjermani, sepse i gjejnë në marketët e lartpërmendur dhe ndihen më afër vendit e traditës së tyre...

VJOLLCA SINANI ZBULON ANËN TJETËR TË BIZNESMENIT...

Është e famshme thënia se “Pas një burri të suksesshëm qëndron një grua e fortë”. E tillë duket të jetë edhe e shoqja e Ilir Sinanit, Vjollca, e cila në këtë intervistë kujton kohën e njohjes me Ilirin, si ia mori zemrën, si është të jesh grua e një biznesmeni të njohur, e të tjera...

“Në kohën kur jemi takuar, njohur, nuk



kishte rrjete sociale si tash. Ishte takim rasti. Dhe, që në takimin e parë Iliri ishte shumë i singertë me mua. Fillimisht, dilnim fshehurazi...

Dhe, sado që ato ditë ishin të këndshme, isha e stresuar, meqë isha shumë e re, vetëm 16 vjeçe.

E, më pas gjërat rrodhën në mënyrën më të mirë të mundshme...”, thotë zonjë Vjollca, bashkëshorte e biznesmenit shqiptar të dëshmuar në Diasporë, Ilir Sinani. “Siç thash më lart, sinqeriteti i Ilirit është i pakrahasueshëm, por edhe atdhedashuria për vendin e vet. Kështu, edhe ma fitoi zemrën”, tha Vjollca, teksa flet për kohën e rinisë së hershme dhe fillimet e lidhjes me Ilirin, atëherë djalë i ri e me ëndrra të mëdha...

Përndryshe, bashkëshortja e Ilir Sinanit është çdo herë përkrah tije dhe kanë bashkëpunim të vazhdueshëm...

“Ndjehem krenare pranë Ilirit dhe jemi bashkë në çdo sukses e sfidë. Çdo sekondë i kaluar me të ka vlerë të veçantë për mua dhe familjen tonë”, shton Vjollca.

Por, edhe Vjollca njihet për shpirtin e saj human... “Po, kam dëshirë të ndihmoj aty ku ka nevojë dhe bëj aq sa mundem”, thotë ajo.

Gruaja dhe mbështetësja e madhe e biznesmenit Ilir Sinani, po ashtu, thotë se për një lidhje të qëndrueshme, të fortë dhe që mund të konsiderohet model, duhet të ketë gjithmonë sinqeritet, mirëkuptim dhe dashuri.

Nderim Neziri



Kurrë s'i dihet jetës...



Petrit Halilaj, refugjat

Dikur refugjat, tash artist i njohur

Petrit Halilaj është artist bashkëkohor, i klasit botëror, që ekspozon ndërkombëtarisht. E, dikur ishte refugjat...

Vepra e Petrit Halilajt, i lindur më 1986, në fshatin Kostërrc, komuna e Skenderajt, është e lidhur shumë me biografinë e tij, historinë e kohës së luftës në Kosovë më 1999 dhe pasojat e tensioneve politike dhe kulturore në rajon.

Kujtimet e fëmijërisë nga drama e luftës dhe jeta e refugjatëve, përsëriten në gjithë artin e tij, i cili përfaqëson tema, si: shtëpia, kombi dhe identiteti kulturor

përmes një shumëllojshmërie të medieve, duke filluar nga vizatimi dhe skulptura, te videot, instalimet, madje, edhe shkrimi.

Petrit Halilaj ka marrë pjesë në Bienalen 6 të Berlinit, më 2010, si dhe e përfaqësoi Kosovën në Bienalen 55 të Venedikut, në vitin 2013, ku edhe mori Mirënjohje Speciale për punën e tij si artist.

Gjithashtu, ka marrë pjesë në Bienalen 15 të Lionit, më 2019.

Ai ka prezantuar punën e tij në ekspozita personale në muze të rëndësishëm dhe qendra arti, si: "Hangar Bicocca" (Milano, 2015), "Bundeskunsthalle" (Bon, 2015) dhe "Muzeun e Ri" (Nju-Jork, 2017).

Pra, Petriti, me pjesëmarrjen e tij në këto Bienale arti, bëri që Kosova të depërtojë në këtë organizim artistik prestigjioz, duke thyer kufijtë e arritjeve.



...tash

Pronar dhe botues:

Gani DILLI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILLI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Dionita Sadrija

Gresa Mehmeti

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

VDES PËR ATA QË MË DUAN...

“Sa çuditshëm e kalojmë pjesën e kohës që e quajmë - jeta jonë”, ka shkruar Stiven Likok.

Çuni thotë: Kur të bëhem djalë i ri...

Djali i ri thotë: Kur të bëhem burrë...

Pasi të bëhet burrë thotë: Kur të martohem...

Më në fund, martohet, por nga kjo pak gjë ndryshon. Ai fillon të mendojë:

Kur të pensionohem...

E, pastaj, kur të arrijë moshën për pensionim, ai e shikon jetën që ka kaluar dhe si një erë e ftohtë i fryn në fytyrë dhe para tij del e vërteta e vrazhdë për atë se sa shumë lëshime ka bërë gjatë jetës dhe se çdo gjë ka ikur në pa kthim...

Ne, bukur vonë, e kujtojmë se kuptimi i jetës është vetë jeta, te ritmi i çdo dite dhe i çdo ore...

*

Ka çaste, raste në jetë, në përditshmëri, kur edhe leximi, përsiatjet të lodhin, të mërzi-tin. Njeriu nganjëherë kërkon shpëtimin në shkujdesje, në mospërfillje...

Mbase edhe pa dëshirë të vjen, të del, të ngacmon, një moment, një fotografi e zverdhur, e kaluar, e ikur, por e dashur gjithëherë dhe gjithëherë e munguar, e dhimbshme... Dhe, tash të rri para syve:

as s'të ikë, as s'të largohet.

Natë e vonë qershori me shi. Më del gjumi nga vetëtimat, bubullimat. Shpirtin s'e kam të qetë...

Kush më kujton?

Kush më thërret?

Ç'më trazon ti moj lemezë në pikë nate?

Bëj luftë midis të tashmes e të ikurës në pa kthim.

Seç më vijnë në kujtesë vargjet e poetit:

“Moj lemezë ç'më thua

Kush më zë në gojë mua

Pa dëgjo, të keqen s'dua

Të kujtoj që kam harrua

Lemë o lemezë menjëherë

Kush e di se kush më qanë, kush më përmend”.

Kur të lëndoj, kërkoj falje. Kur të lutem, dobësi nuk tregoj. Kur të thërras, ndjej pakënaqësi. Kur heshtë, ta jap përgjigjen që dua unë dhe jo atë që e pret apo e kupton ti...

Kur kam diçka për ty - ta them në sy. Kur ti qesh e qanë, edhe unë jam me ty. Sepse, jam njeri...

*

Vdes për ata që më duan

Jetoj për ata që ma kanë inati

Ha-ha-ha...

Më 12 maj 1999, në vendin e quajtur “Përroi i Zharajve”, në Nishevc të Prishtinës, serbët kanë shtënë me armë zjarri mbi shqiptarët, duke vrarë e plagosur shumë prej tyre...

“Ditën e Bajramit e kemi braktisur lagjen tonë, e që është në hyrje të Prishtinës, për t’u larguar në fshatin Prapashticë”, fillon rrëfimin Pajazit Islami (1969), nga Prapashtica, njeriu i cili i shpëtoi vdekjes në vendin e quajtur “Përroi i Zharajve”.

Trupin e tij e kanë shpuar shumë plumba automatiku, krahas shumë shqiptarëve të tjerë të vrarë në atë luginë nga paramilitarët serbë, të cilët nuk i kursyen as fëmijët e gratë që i kishin grumbulluar aty.



Si ecte gjaku i të vrarëve në “Përroin e Zharajve” në Nishevc?

“Pas dy javësh qëndrimi në Prapashticë ka hyrë ushtria serbe me forca paramilitare. Kanë ardhur nga drejtimi i “Mutivodës” dhe u vendosen te “Dheu i Kuq”, duke zënë pozicione rreth malit.

Ushtria jonë qëndronte në pozicione te përroi, por numri i tyre ishte i vogël...

Serbët, të pozicionuar në “Kodrën e Sukës”, kanë qëndruar nja një javë, derisa edhe ndërmorën ofensivën në Orllan, që ta orientonin popullatën të lëvizte në pjesë të tjera të Gallapit, ku do të binin në prita serbe.

Dhe, kur nisi ofensiva serbe në Llap, popullata e fshatrave Orllan, Kalaticë, Brainë, Bërvenik, Kushevicë, Nishevc, ka qarkulluar deri në Prapashticë, e pastaj në Keqekollë.

Edhe ne iu bashkëngjitëm kolonës, sepse po të rrinim aty ishte rrezik. Kur arritëm në Lagjen “Sinanaj”, që ishte tërësisht e zbrazët, janë djegur disa shtëpi, ndërsa zjarri përfshiu edhe shkollën.

Nga aty pamë se si digjej Ballabani, shtëpitë e Manqastenëve... Qëllimi ishte që forcat serbe që e kishin sulmuar Prapashticën dhe ato që e kishin sulmuar Orllanin, të takoheshin në qendër të Keqekollës.

Dhe, nga një vend në tjetrin, i kemi

kaluar dy javë në këtë rajon”, tregon Pajaziti.

SI U VRA VËLLAI I 7-të MOTRAVE NË NISHEVC?

“Pas granatimeve të shumta, u detyruam të strehohemi në “Përroin e Zharajve”, luginë afër fshatit Nishevc. Më 5 maj, rreth orës 16, në përpjekje për të siguruar bukë dhe barëra për nënën e sëmurë e të paralizuar në Nishevc, u vra Fadil Islami, 25 vjeç. Ishte vëllai i vetëm i shtatë motrave, që la gruan dhe djalin katër vjeç.

Tutje, më 12 maj, forcat çetnike serbe rrethuan “Përroin e Zharajve” dhe në orën 15 filluan të shtënat mbi popullatën civile nga të gjitha anët.

Gjatë asaj ofensive serbe janë vrarë: Osman Rrahmani (27), Ahmet Islami (21), Nazife Bislimi (60) dhe Ajshe Aliu (65). Janë plagosur rëndë: Bajram Bajrami, nga Keqekolla, Pajazit Islami (unë), nga Prapashtica dhe hoxhë Beqir Islami.

Dhe, të gjithë ne, e që ishim të plagosur (unë, Bajrami, nëna e Fadilit të ndjerë, gruaja e hoxhës Mihrija (e paralizuar) dhe Hava Islami), mbetëm nën mëshirën e Zotit...

Ne, të plagosurve, na ngarkuan në traktor, ndërsa plakën e paralizuar e lanë në tendë, pa përkujdesjen e askujt.



E, të tjerët i morën me vete dhe u nisën në drejtim të Keqekollës. Pas 5 ditësh mundimi, plakën e paralizuar serbët e kanë vrrarë në tendë, ndërsa ne kemi vazhduar për Keqekollë, të përcjellë nga serbët dhe na kanë mbajtur peng në mullirin e Prapashticës.

Nga plagët në mulli vdiq Bajram Bajrami dhe e kemi varrosur në oborrin e mullirit.

Dhe, katër ditë pas vdekjes së Bajramit në mulli, serbët na dërguan në një fshat andej kufirit Kosovë-Serbi, në Tullar. Ishim të bindur se do na vrisnin...

Por, pas pak ditësh na kthyen sërish në Orllan, pastaj në Lluzhan e në Podujevë.

Në Podujevë banesat shqiptare i kishin shndërruar në stacione policore. Në to, shqiptarët, së pari, i merrnin në bisedë informative, e pastaj vendosej më tej për fatin e tyre.

Më 20 maj na dërguan në stacionin policor në Podujevë. Na mbështetën për muri të na vrisnin. Por, kur ne pritnim vdekjen, u vendos ndryshe dhe nuk dimë se kush na shpëtoi! Për çudi, na lëshuan, përveç Bekim Jasharit, që kishte qenë në burgun e Pozharevcit. Atë e ndalën.

Kur na liruan, vazhduam rrugën për në Shajkoc, që t'i bashkëngjiteshim turmës së njerëzve, tregon Pajazit Islami, nga Prapashtica.

“DJALIN IA VARROSËM, NËNA I VDISTE”!

Plaku Ramadan Bunjaku, 77 vjeç, nga Prishtina, me lot në sy sjell dëshmi nga dhuna serbe në krahinën e Gallapit, kur forcat e dhunës serbe

plagosën djalin e tij, Enverin, e i cili, pastaj, vdiq nga plagët. Ndërkaq, bashkëshortja e Ramadanit, (nëna e Enverit) Azizja, e sëmurë dhe e lodhur nga mundimet e luftës, vdiq vetëm dy orë pas varrosjes së të birit, posa e kuptoi se djali i saj, Enveri, kishte ndërruar jetë...

Ramadan Bunjaku për këtë tragjedi pohon:

“Me shpresë se do gjejmë pak qetësi, nga Gallapi kemi kaluar në Makovc më 30 mars, kur Prishtinën e braktisi shumica e popullatës. Kemi qëndruar tri javë në lagjen “Gëlmivda”.

Por, edhe këtu filloi terrorizimi i vërtetë i shqiptarëve. Forcat paramilitare-ushtarake serbe hynë në lagje dhe i ndanë burrat nga gratë...

Ishim rreth 130 burra. Na kanë mbështetur për muri, duke na e tërhequr vërejtjen se po lëvizëm do na vrasin.

Dhe, kur prisnim se do na pushkatonin, ai i cili edhe komandonte, pas një bisede me dikë në radio-lidhje, pasi shau serbisht, filloi të na shqelmojë një nga një...

Pastaj, na liruan dhe filluan djegien e shtëpive në Lagjen “Vitija”.

Në ato çaste jemi nisur drejt Busisë.

Por, te shkolla e Mramorit hasëm në grupin tjetër të forcave serbe.

E keqja më e madhe për mua ishte se bashkëshortja ime, Azizja, ishte e sëmurë dhe atë e mbanin për krahësh djemtë.

Por, ditën tjetër nisën granatimet në Lagjen “Ugriaj”. Nga të shtënat është plagosur djali, Enveri. Pesë plumba e kapën në trup. Por, pas një kohe Enveri u zhdruk... Dhe, kur e gjetëm, ai veç ishte i vdekur. E, kur e kuptoi Azizja se djali i kishte vdekur, vdiq edhe ajo...

Kështu, në këtë vend, i kaluam 12 ditë. Në ditën e dymbëdhjetë, kur pak ishin rralluar krismat, ndërruam vendin, duke ikur nëpër thera për t'u strehuar në Makovc”.



NË KOLOVICË DERI NË ÇLIRIMIN E KOSOVËS...

“Meqë edhe në Makovc nuk kishte siguri, sepse forcat serbe endeshin poshtë e lart, u nisëm për në Lagjen “Kolovicë” të Prishtinës.

Në këtë lagje kishte ende shumë shqiptarë, por që rrinin mbyllur në shtëpitë ku ishin vendosur. Askush nuk dilte nga shtëpitë, rrugët ishin të zbrazëta...

Dhe, kështu, kemi jetuar deri në ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, më 9 qershor 1999...”, tregon bashkëbiseduesi ynë, përjetuesi i gjithë atyre ngjarjeve, Ramadan Bunjaku.

SI U PRIT LIRIA?

Plaku Ramadan Bunjaku ka treguar edhe si është pritur liria. Dhe, ja detajet:

“Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, për tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, serbët i bastisnin shtëpitë nëpër Prishtinë kudo që arrinin. Krisma armësh dëgjoheshin në çdo lagje të Prishtinës...

Por, edhe UÇK-ja hyri në Prishtinë dhe ishin vendosur në “Kolovicë”. Dhe, më në fund, erdhi edhe dita e çlirimit! Lajmi për hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë ishte i papërshtueshëm...

Por, edhe dalja e UÇK-së në rrugët e Prishtinës ishte një përjetim që s'harrohet kurrë...”, përfundon plaku Ramadan Bunjaku.



Safet Krivaça

P. S.

Ky shkrim është botuar në Revistën “Kosovarja”, viti 2000. Po e ribotojmë me rastin e çlirimit të Kosovës, në shenjë sakrifce të të gjithë atyre që dhanë jetën për lirinë që ne sot e gëzojmë.



Errallë



Sami Dangëllia në burg

Cili shqiptar mbajti burg më shumë se Adem Demaçi?

Sami Dangëllia është rekordmeni shqiptar që ka vuajtur 43 vjet burg dhe vdiq në burg.

Janë të shumtë ata që patën fatin të mbetën gjallë dhe që e kanë njohur Sami Dangëllinë e burgjeve të gjatë, që i morën edhe jetën.

Kanë njohur Sami Dangëllinë e urtë e fjalëpakë, të heshtur përballë vuajtjeve dhe torturave, frymëzues për shokët e miqtë, për t'u dhënë zemër edhe në atë ferr mbi tokë. Ishte një nga ata që me shembullin e vet ta bënte më të durueshme jetën në vuajtje, e pse jo të kujtonte se kur e di përse vuan, njeriu i gjen kuptim edhe vdekjes.

Si mik i tij nga brezi më i ri i të burgosurve politikë të kohës, pata fatin të mbetëm gjallë dhe t'i shkoja Samiut një ditë në vendlindje, në Menkulasin e tij buzë Devollit. Aty, buzë lumit Devoll, më treguan

se kishte qenë dikur vatani i Sami Dangëllisë, por shtëpia e tyre nuk ishte më. Ai që më përcolli te vatani i dikurshëm i Samiut ishte një Dangëlli i largët dhe dukej ca i hutuar, sikur po i kërkoja t'më fliste për botën tjetër.

KUSH ISHTE SAMI DANGËLLIA?

I lindur në fshatin Menkulas të Devollit, në vitin 1926. Fëmijërinë e kaloi në fshat, më vonë shkon ushtar dhe që andej bashkohet me Ballin Kombëtar dhe bëhet një nga aktivistët kryesorë të krahinës.

Më 1944 Sami Dangëllia arrestohet dhe burgoset në burgun e Korçës dhe një vit më vonë e shpallin "armik të popullit".

Më pas u vendos në burgun e Burrelit dhe më 1960 ridënohet me 25 vjet burg. Më pas kalvarin e vuajtjeve e kaloi në Spaç, ku punonte shumë për të nxjerrë bukën e gojës shtesë, pasi nuk kishte asnjë ndihmë nga të afërmit.

Më 21 Maj 1973 ishte një nga organizatorët e revoltës së Spaçit. Pas revoltës së Spaçit, Dangëllia ridel për të tretën herë



Sami Dangëllia në kohën e rinisë

në gjyq dhe dënohet me 25 vjet burg dhe 5 vjet humbjen e qytetarisë pas burgut. Vdiq në moshën 61 vjeç në burg, duke mbajtur 43 vjet burg, gati sa dyfishi i Mandelës. Sipas dokumenteve të burgut, vdekja u regjistrua më 23 prill 1987, në orën 23. Varrimi u bë nga burgu, pa e parë askush dhe pa e ditur se ku u varros.

Daut Gumeni

remos®



Aachener Straße 21 | Köln
Ulmenstraße 30 | Frankfurt
Westerwaldpark 4 | WW
Bahnhofplatz 5 | Koblenz
remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

*Ra një përqa-
fim dreqi, që
ia bëri ditë më
parë një për-
faqësues i ekip-
it të Shqipërisë
këngëtares ser-
be që këndoi
në “Eurovision”
(aq më keq me
flamurin kuqezi
në dorë) dhe
m’i solli në
mendje 1001 të
këqija, e që ka
ditë që nuk më
lënë rehat.
Por, “hajr
koftë”, siç
thotë shpesh
Kimete Berisha
në shkrimet e
saj...*

Ditë më parë, në “Eurovision”, pasi u kualifikua për finale ekipi i Serbisë, një përfaqësues i ekipit të Shqipërisë shpejt e shpejt e uroi këngëtares nga Serbia dhe e përqafoi fort...

Por, ai përqaftim më ktheu me mendje në vitin 1990, kohë kur ne, shqiptarët e Kosovës, përjetonim tmerrin serb nga regjimi i Millosheviqit, i cili synim kryesor kishte largimin e shqiptarëve nga Kosova, e ata që do mbesnin gradualisht t’i asimilonte...

Më ktheu me mendje edhe në kohën kur për herë të parë shkela në Shqipëri, më 1 shtator 1990, kohë kur shkela në tokën e amshuar, tokën e ëndrrave, në Shqipërinë që e deshëm sa edhe Kosovën.

Sepse, profesor Naim Basha, emigrant nga Shqipëria, në Normalen e Ferizajt na i nguliti në kokë vargjet “Ku na duket balta, më e ëmbël se mjalta – në Shqipëri”. Por, kur këmbët e mia shkelën në Shqipëri,

në pikën kufitare Kapshticë (kufiri Greqi-Shqipëri), jo mjalte, por pamje tmerrri pash kudo, e që, edhe tash, pas më shumë se 30 vjetësh, nuk më hiqen dot nga mendja...

HIQU MORE SHKURTE FEJZËS! A E KE KASETËN E VESNA ZMIJANACIT?

Turma e madhe e njerëzve në kufi kërkonin nga turistët e huaj (të huaj në atë kohë për Shqipërinë ishim edhe ne, kosovarët) t’u dhuronin ndo gjë për të ngrënë...

U rrethua vetura ime nga shumë vetë, të rinj e të moshuar. E ula xhamin e veturës dhe i përshëndeta. Njëri, pasi u shikua në pasqyrën e veturës, u mundua ta nxirrte, por ajo nuk shkoqej. Tjetri kërkonte çamçakëz. Një tjetër - çokollatë. E, një tjetër më tha: “Paske edhe kasetofon në makinë, a?”.

“Po”, ia ktheva.

“Ke edhe kasete?”.

“Po. E do një?”, i thash.

“Po, veç a ma jep!”, më tha.

“E do Shkurte Fejzën, Shyhrete Behullin, Remzie Osmanin?”, i thash.

“Çfarë Shkurte Fejza, bre!”. Hiq saj! A e ke Vesna Zmijanacin?”, ma ktheu ai.

“Çka po thua, bre?! Çfarë Vesna Zmijanaci! A dëgjon ti këngë serbe, a? A di serbisht?”, ia ktheva i nevrikosur.

“Jo, nuk di serbisht, por këndon bukur!”, më thotë ai shumë i qetë.

“Po ku këndon bukur Vesna Zmijanaci, bre?!”, i them shumë i nervozuar.

“Aiii, po ti nuk po e kuptojshë artin!”, ma ktheu ai.

“Jo, nuk unë e kuptoj artin e Vesna Zmijanacit dhe as që dua ta mësoj!”, i them, teksa dua të largohem, por masa e njerëzve ma kishte rrethuar veturën dhe nuk mund të vazhdoja

Pse Shqipëria gjithmonë ka mall për Serbinë?

tutje, derisa erdhën dy policë dhe i larguan nga rruga, sepse edhe dy vetura të tjera pas meje, me regjistrim të Kosovës, nuk mund të vazhdonin rrugën tutje, pa ecur unë, meqë rruga ishte e ngushtë.

SA HERË QË SERBIA E KA RRRITË BRUTALITETIN NË KOSOVË, NË SHQIPËRI KA KRIS DIÇKA!

Që nga viti 1990 Serbia haptazi ndërmoi fushatën për largimin e punëtorëve shqiptarë nga puna dhe dëbimin e tyre për në Perëndim, me qëllim të zbrazjes së Kosovës. Dhe, kujt nuk iu dhimbën gjithë ata shqiptarë të Kosovës që në atë kohë ia mësyn Suedisë, Norvegjisë, Gjermanisë dhe vendeve të tjera të Evropës? Por, në kohën kur veç filloi të mbushej kupa dhe bashkësia ndërkombëtare i jepte përkrahje të madhe Kosovës, në Shqipëri doli në skenë rebelimi i vitit 1997, i njohur ndryshe edhe si Kriza piramidale, Anarkia në Shqipëri, Lufta Civile...

Shkaku i rebelimit ishte falimentimi i skemave piramidale, të cilat morën me vete rreth 1.2 miliardë dollarë kursime të shqiptarëve. Opozita arriti të përfitonte nga situata e rëndë dhe i kanalizoi protestat në rrugë politike, duke kërkuar dorëheqjen e qeverisë dhe të Presidentit Berisha. Paaftësia dhe dezertimi në radhët e ushtrisë bëri që vendi të binte në duart e bandave të armatosura, e sidomos pjesa jugore.

Dhe, mu ajo gjendje kaotike bëri që vëmendja e ndërkombëtarëve të përqendrohet në Shqipëri, e Kosova të mbetet nën hije deri më 1999, kohë kur edhe filloi lufta në Kosovë.



Në vitin 2014 Edi Rama ia dorëzoi "Çelësin e Tiranës" Goran Bregovićit, i cili me këngën "Pucaj!" (Gjuaj!) u këndoi himne vrasjeve serbe në Kosovë

RA GORAN BREGOVIQI DHE I DOLI FLAKA TIRANËS!

Në tetor të vitit 2014, serbi Goran Bregović mbajti koncert në Tiranë. Gjatë tërë koncertit pjesëmarrësit qëndruan në këmbë, duke i duartrokitur.

Por, kënga e tij "e famshme" - "Kallashnikov", bëri që duartrokitjet të dëgjohej edhe jashtë sallës...

Edi Rama, aso kohe kryetar i Tiranës, jo vetëm që u kënaq me performancën e Bregovićit, por i dhuroi edhe "Çelësin e Tiranës", në shenjë mirënjohjeje!

E, një gjë e tillë shkaktoi zhgënjim të madh te ne, shqiptarët e Kosovës. Por, jo vetëm të Kosovës...

Sidoqoftë, Edi Ramës, tash kryeministër i Shqipërisë, sikur i dhimbset ende Serbia dhe bën përpjekje t'i ndihmojë asaj që të kalojë nëpër Kosovë e të dalë në brigjet e Adriatikut me "Mini-Shengenin Ballkanik", kinse me shkëmbim mallrash, por prapavija është kryekëput politike.

E, a do i mundësohet Serbisë të shëtisë

poshtë e lart nëpër Kosovë, kjo varet nga Qeveria aktuale...

SI TA PËRMBYLLË KËTË SHKRIM?

Nuk jam historian dhe nuk më takon të hyjë në të kaluarën paksa të largët, kohë kur ende nuk isha i lindur.


Megjithatë, në shkollë kemi mësuar se me revolucionin demokratik të Fan Nolit, në qershor të vitit 1924, Ahmet Zogu me bashkëpunëtorët e tij të ngushtë ikën në Jugosllavi dhe i priti mirë Nikolla Pashiqi, i cili edhe e ndihmoi Zogun që të kthehet sërish në Shqipëri, në dhjetor të po atij viti dhe ta rrëzojë qeverinë e Nolit...

E, si shpërblim, Ahmet Zogu i dha Serbisë Shën Naumin, i cili tash ndodhet në territorin e Maqedonisë. Kjo dhuratë u bë në vitin 1925 e u legalizua në vitin 1926.

Sidoqoftë, ky ndryshim i padrejtë i kufirit shqiptaro-jugosllav, në dëm të Shqipërisë, është kritikuar vazhdimisht, qëkur u nënshkrua. Madje, vazhdon të kritikohet edhe në ditët tona...

Dhe, dashtë Zoti, të mbushemi mend e të mos ndodhin më pazare të tilla, të cilët ngushtojnë tokat shqiptare...

Isa ILAZI



Më 1997 Shqipërinë e morën nën kontroll bandat e ndryshme...



Shën Naumin e bukur Ahmet Zogu ia dhuroi Serbisë!



Pse merremi me fjalët ke thënë, ka thënë?

Kosovarët harxhojnë 500 mijë euro për telefonata në ditë! Shifër marramendëse për një popullatë të varfër, madje skajshmërisht të varfër, sikur jemi ne, në Kosovë!

E, kur kjo shumë zërthehet, del se në çdo të dytën ditë harxhohen rreth një milion euro për telefonata, në dhjetë ditë pesë milionë, në 100 ditë pesëdhjetë milionë e në 365 ditë të mos flasim se trishtohet njeriu...

KAM THËNË UNË, KE THËNË TI, KA THËNË AI...

Për çka, a thua, bëhen gjithë ato telefonata? Me siguri, badihavxhil-

lëku kërkon llafe e biseda, ndër të cilat prijnë thashethemet.

Dhe, ku ka popull në botë që jep para për të ndezur thashetheme pos te ne? Para meje po qëndronte një zonjë a zonjushë, sepse nuk i shkruante në ballë asnjëra dhe fliste me dikë. Unë prisja autobusin, por edhe ajo e priste. E dëgjova kur i thoshte telefonuesit a telefonueses: "Unë s'i kam thënë asgjë! Paska rrejt, se as që më ka shkuar mendja për atë gjë me fol për ty!"

E, fjalë e fjalë, dikur bukur shumë e nxehën atmosferën, sa ma mori mendja se po të ishin afër do të rriheshin në rrugë.

Dhe, sa e sa fjalë i shkëmbyen dhe për çka se... Për thashetheme! Ke thënë ti, ka thënë ai, s'kam thënë unë, s'ka thënë ai...

Mendoj, tutje, se sa është e shprehur

varfëria te ne dhe shpenzohen para për biseda telefonike pa karar...

KËNDEJ ANKOHEMI, ANDEJ TË GJITHË NË SHQIPËRI!

Në anën tjetër, çdo vikend - të gjithë në Shqipëri! Verës të gjithë në det - në pushime verore!

Mirë shumë, sepse kjo tregon se nuk jemi për ankesa. Edhe shtëpi të vjetra në fshatra më nuk ekzistojnë... Por, varfëri kah të duash...

A thua, është kjo dukuri që e kemi ne për t'u ankuar? Dikur i janë ankuar mbretit, pashait, beut, padronit... E sot, kujt t'i ankohe mi?

Dashtë Zoti e të humbë ky ves i ankesave se jemi të varfër...

Në Gjakovë dikur thuhej: "Edhe i varfëri mund të jetë zotëri!"

S. M.



MORINA PALACE



Adresa: Dhërmi, Shqipëri; **Reservation:** info@morinapalace.com; **Tel:** +355 68 809 9999

Babë, nënë dhe vëllezër artistë të njohur

Koha është ajo që lë kujtime pas, e që herë-herë janë të freskëta, edhe pse breznitë shkojnë e vijnë. Këtë herë do bëjmë fjalë për familjen Stafa, nga Gostivari, e që e tërë familja janë artistë të njohur. Fjala është për Enver Stafën, Shahindere Bërlajollin, Ardit dhe Astrit Stafën.



EnverStafa

ENVER STAFA

Enver Stafa ishte kompozitor i njohur nga Gostivari. Enveri, sa ishte gjallë, çdo bisedë e fillonte me thëniet e Shabanit, vëllait të tij të madh, me qëndrimin e tij dhe me përkushtimin e tij për këngën dhe për shkollën shqipe në Gostivar. Kënga e asaj kohe cilësohej si ligjëratë muzikore, si formë për të përhapur dashurinë e gjuhës sonë, të traditave tona te gjeneratat e reja... Sepse, në atë kohë janë bërë përpjekje të mëdha për t'i ruajtur vlerat tona kulturore kombëtare,

pa ndryshuar gjë nga thesari artistik. Dhe, kujt nuk i kujtohet kënga e tij e njohur "Një lule në Gostivar"?

SHAHINDERE BËRLAJOLLI

Rrjedh nga një familje pejane, e njohur për kontributin e vlerave brenda familjes. Më 1959, në moshën 13-vjeçare, bëhet siolistja e parë dhe më e reja profesioniste në muzikën artistike popullore. U martua me kompozitorin e njohur nga

Gostivari, Enver Stafën, e që sollën në jetë binjakët Arditin dhe Astritin.

Repertuari i këngëve të saj arrin në 280 sosh, shumica e të cilave është regjistruar në Radio-Prishtinë, si dhe në Televizionin e Prishtinës.

Me ëndje do i kujtojmë përherë këngët e saj origjinale popullore "Në zabel të erdha", "Kush ma i pari bani", "O bylbyl me pikapika", "Një lule në Gostivar", "Gajdexhiu", "Baresha e dashnume", "Lules" etj. Dhe, me këto këngë u rritën gjenerata të tëra, e që me ëndje dëgjohen edhe tash.



Shahindere Berljajli

ARDIT STAFA

Ardit Stafa, i lindur në Prishtinë më 1980, është këngëtar dhe autor i shumë këngëve të njohura. Tenor lirik, pedagog i kantos, profesor i pianos dhe solfezhit në Gostivar. Fitues i Edicionit 2 "VIP Shpija" në Kosovë. Pjesëmarrës dhe fitues i shumë çmimeve në festivale, si: "Nota Fest", "Shou Fest", "Poli fest" dhe "Festivali i Këngës".

Në Dhjetor 2001 Ardit Stafa merr pjesë në Festivalin 40 në RTSH, me këngën "Elegji". Më 2003 Gili & Ardit Stafaj marrin pjesë në "VFM 2003", me këngën "Ditët e fundit". Po atë vit merr pjesë në "Poli Fest" me këngën "Njerëzit e vetmuar".

Dhe, kështu me radhë...

Andaj, këngët e tij dhe duetet me këngëtarë tanë të njohur, nuk mund të përmenden të gjitha, sepse vargu i tyre është shumë i gjatë...

ASTRIT STAFA

Astriti është lindur në vitin 1980, në Prishtinë. Është artist i famshëm shqiptar dhe muzikant revolucionar në skenën e muzikës shqiptare. Astriti është kitarist eksperimental, virtuoz dhe multi - instrumentist.

Karrierën e filloi si 5-vjeçar, e kur i mbushi 7 vjet filloi të performojë në piano dhe kitarë.

Studioi pedagogjinë e muzikës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Studimet postdiplomike i përfundoi në Aranzhim, në klasën e Prof. Valton Beqirit. Tani është ligjërues në Universitetin AAB, profesor në shkollën e mesme profesionale të muzikës në Gjakovë "Prenk Jakova" dhe instrumentist në programin televiziv "Oksigjen show".

Astriti është mjeshtër virtuoz i instrumenteve me tela. Është njohës i muzikës, në përgjithësi, i stileve dhe zhanreve të ndryshme muzikore.

Ai luan profesionalisht në ud, saze të ndryshme, buzuk, kitarë etj.

Astriti, përveç që lozë me muzikën tradicionale, e që u takon këtyre instrumenteve, ai përdorë teknika të ndryshme dhe i përshtat profesionalisht këto instrumente me muzikën tonë tradicionale popullore shqiptare.

Por, përveç muzikës tradicionale, Astriti është aktiv dhe performues i muzikës artistike serioze.

Astriti ka pasur bashkëpunime me artistë lokalë, rajonalë dhe internacionalë. Ka qenë pjesë e shumë festivaleve në trojet shqiptare dhe jashtë vendit.

Thënë shkurt: Kjo është familja e madhe Stafa, familje artistësh të vërtetë...

Shefqet Mani



Ardit Stafa



Astrit Stafa

Eda Zari: Pse Kosova nuk ftohet në "Eurovision"?

Atë që duhet bërë e nuk e bën Ministria e Kulturës e Kosovës, si dhe njerëz të tjerë kompetentë në Kosovë, e bënë ajo që e do Kosovën, Eda Zari...

Eda Zari është këngëtare, producentë dhe kompozitore e njohur nga Shqipëria dhe muzika ku identifikohet më shumë është ajo pop dhe jazz.

Eda është pinjollë e dinastisë Lela, një ndër grupet e mirënjohura të muzikës tradicionale Përmetare. Në moshën 16 vjeç prezantohet në festivalin kombëtar të RTSH-së. Kryen maturën, dega Kanto, në Liceun Artistik "Jordan Misja" në Tiranë.

Por, pas dramës politike që familja e saj pësoi në shkurt të vitit 1990

(Ilijaz Zari u vra nga forcat kufitare të regjimit komunist), Eda emigron për të vazhduar studimet në Gjermani, në Konservatorin e Kelnit, ku edhe diplomoi.

Gjatë kësaj kohe është soliste në projekte të ndryshme, duke përfshirë: Opera, Musical, Opereta dhe shumë prezantime recitale të formës koncertale.

Eda deri më tash ka realizuar nëntë albume muzikore.

Por, qëllimi i këtij shkrimi nuk është fokusimi te arritjet e saj në skenat muzikore botërore, sepse

këtë e di gjithkush, por e një deklaratë të saj shumë e qëlluar: Pse Kosovën, si shtet i pavarur që nga viti 2008, nuk e ftojnë në Festivalin më të madh evropian muzikor "Eurovision"?

E, Ministria jonë e Kulturës, por edhe njerëz të ndryshëm të kulturës dhe jetës sonë muzikore heshtin dhe merren me politikë boshe, në vend se të kërkojnë që Kosova të jetë kudo e pranishme në festivalet evropiane dhe më gjerë...

Selim Rama



Giovanni's Beach

COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269336233

Jam duke kaluar një periudhë të tmerrshme, shkaku i fundit të një historie dashurie me një grua të martuar. Fatkeqësisht, nuk mund të flas me askënd për këtë histori dhe, kësh-tu, po u shkruaj sa për t'u shfryrë paksa, sepse nuk mundem më ta mbaj të gjithë dhimbjen i vetëm brenda vetes...

Gjithçka ka nisur rastësisht. Ne punonim bashkë dhe shkonim në qytete të ndryshme për shkak të punës. Është disa vjet më e vjetër se unë. Është shumë e bukur, por e martuar para

N'desh me e dënua veten dashurohu në grua të martuar!

dhjetë vjetësh. Patëm një pëlqim dhe tërheqje për njëri-tjetrin, por gjithnjë silleshim me respekt dhe pa i rënë në sy tjetrit që kishim interes.

Para dy vjetësh, përpara Vitit të Ri, kur duhet të shkëputeshim, ndodhi që u puthëm. Që nga ai moment lindi gjithçka, nisëm të flasim në telefon shumë shpesh, madje u lidhëm shumë me njëri-tjetrin. Herën e parë që u ritakuam bëmë dashuri.

SA HERË PUTHESHIM THOSHIM:

SOT MORI FUND!

Vazhduam kështu të takoheshim për një vit dhe e gjitha në fshehtësi të plotë. Çdo herë që bënim dashuri i thoshim njëri-tjetrit se historia jonë duhet të merrte fund për shkak të situatës në të cilën ndodheshim.

E dinim shumë mirë që nuk mund të ishim kurrë bashkë dhe fshehtësia po na lodhte. Gjithnjë afroheshim edhe më shumë dhe ndihesha xheloz sa

herë që mendoja se, pasi ndahej nga unë, do të shkonte në shtëpi te tjetri, te bashkëshorti i saj.

Më pas, hyri në lojë një mashkull tjetër, ishte shumë i bukur dhe në atë moment ne nuk ishim më ne, nisëm të grindeshim gjithnjë e më shumë.

Andaj, më në punë nuk i flisnim njëri-tjetrit. Provoja t'i shkruaja natën, por nuk më përgjigjej...

Por, një natë mora një sms nga ajo. Fillimisht më tha se nuk i kishte parë mesazhet, më pas më tha se ishte mërzitur me mua, prandaj edhe nuk donte t'më përgjigjej.

Dhe, si përfundim, më tha se nga mesazhet e mi e kishte kuptuar se mes nesh ka marrë fund çdo gjë.

Por, unë s'po mund të pajtohem me këtë gjë dhe po vuaj gjithnjë e më shumë...

E, deri kur kështu, një Zot e di... Sidoqoftë, jam penduar që jam dashuruar në grua të martuar. Dua t'i fshij të gjitha kujtimet me të, por nuk po arrij dot...

L. Lazi

BOOM

Zonja Shemsije,

*shembull i gruas profesionale,
moderne, familjare...*

**Edhe sa ditë martohet
Edita Sopjani?**

**Melinda Ademi,
e para në listën
e këngëtareve favorite**

**Alban Ramosaj - urgani
i skenës shqiptare**

**Si e mundi diabetin
Rina Balaj?**

**Sa është e fuqishme
dashuria e VIP-ave tanë?**

Shemsije Selimaj-Fetahu tashmë është bërë emër i njohur, falë historisë së saj të suksesit me "ZAK Clinic" (Klinikën dentare në Zvicër), që ofron shërbimet më profesionale e cilësore në fushën e stomatologjisë.

Siç dihet, Shemsija është pronare e "ZAK Clinic", derë e hapur për pacientë dhe klientë, të cilët duan të kenë dhëmbë të shëndetshëm, por edhe buzëqeshje të mahnitshme, holivudiane. Shemsija, pa dyshim, paraqet shembullin e gruas profesionale, etike, familjare, por edhe moderne dhe me botë të madhe. Për Ju, në "Boom", zonja e "ZAK Clinic", Shemsije Selimaj-Fetahu...

Shemsije, ke arritur të bëhesh grua e suksesshme. Si arrite?

- Si fëmijë kam qenë shumë aktive, kam lozur shumë dhe, disi, i kam udhëhequr fëmijët e lojërat në lagje. Shkolla më ka shkuar mirë, edhe pse pak kam qenë dembele, ama provimet i ka dhënë me kohë, sepse kam mësuar me përkushtim.

Dhe, si 14-vjeçare, jam drejtuar në profesionin e teknikës dentare dhe gjërat kanë rrjedhur shumë mirë, edhe pse gjithmonë kam thënë dhe them se shkollimi dhe të arriturat nuk kanë kufi...

Zonja Shemsije, shembull i gruas profesionale, moderne, familjare...



Cila është rruga drejt triumfeve dhe a ka sfida, vështirësi?

- Shpesh më ka rënë të dëgjoj prindër, duke u lutur që fëmija t'u shkojë në rrugë të drejtë, të mirë. Por, unë mendoj se nuk ka rrugë të mirë a të keqe. Sepse, varet nga gjithsecili si e sheh rrugën...

Kështu, ka lloj-lloj rruge: të drejtë, me leqe, me gropa... Bile, ndonjëherë njeriu e gabon rrugën, por nuk do të thotë se është fundi i botës... Sepse, në secilën ecje gjatë rrugës drejt suksesit apo arritjes së qëllimeve personale, mund të rrëzohesh a të ngrihesh, të vrahesh a lëndohesh, të qash a qeshesh.

Dhe, pavarësisht të gjithave, rruga vazhdon... Por, çdo rrugë është edhe sfidë në vete, meqë shpeshherë është përballje me të panjohurën. Mirëpo, mjafton ta duash dhe respektosh veten, të kesh vetëbesim dhe qëllime të forta.

E, kjo është rruga drejt triumfit...

Cili është sekretin më i madh për të arritur qëllimin, synimin?

- Vetëbesimi. Sepse, kur nuk ke vetëbesim, nuk mund të dalësh as jashtë derës së shtëpisë.

A do të mund të ishe kjo që je sot në Zvicër, po të ishe në Kosovë?

- Nuk di, nuk mund të flasë për diçka që nuk e kam provuar...

Si je ndjerë kur ëndrra jote për të pasur biznesin tënd është bërë realitet?

- Nuk është se kam punuar non-stop për realizimin e ëndrrës sime, meqë kam pasur edhe prioritete të tjera: familja, fëmijët, shtëpia. Sepse, secila nga këto që i përmenda kërkon kohë e përkushtim.

Por, kur vendosa të punoj në

këtë drejtim dhe gjithçka u bë siç doja, atëherë më është dukur se diçka e pamundur është bërë e mundur...

Çka konsideron fitoren më të madhe në jetë?

- Për mua, fitorja më e madhe është të jem shembull i pakrahasueshëm për fëmijët e mi. Përndryshe, vetë puna është jetë, është fitore. Sepse, pa punë s'ka jetë...

Andaj, përvishni mangët dhe punoni! Punoni pa u ndalur!

Angazhimi yt si grua profesioniste dhe nënë e dedikuar, a të lodhë?

- Përkundrazi, këto janë dy pika të rëndësishme për sukses të mirë. Familja ta kënaqë shpirtin, kurse profesioni ta lehtëson jetën.

Kështu, në punë lodhesh, kurse në shtëpi kënaqesh...

Si motivohesh?

- Me dashuri.

Ç'porosi ke për femrat që kanë frikë dhe nuk mund të dalin nga "guaca" e tyre?

- Të lexojnë libra motivues dhe të kenë vetëbesim. Megjithatë, nuk mendoj se femrat kanë frikë, por u druhen paragjykitimeve dhe dështimeve në jetë. Andaj, u bëj apel të mos kenë frikë, sepse më mirë është të dështosh sesa të mos provosh kurrë në jetë dhe të të mbetët merak.

Pra, rrezikoni! E rëndësishme të bëni përpjekje që t'i realizoni synimet tuaja...

Në anën tjetër, më dhimbsen disa gra të martuara, e të cilat kanë bashkëshortë që nuk u besojnë, i nënvlerësojnë, e aq më keq nëse i nënçmojnë...

Cili është roli i bashkëshortit Tuaj në suksesin tënd?

- Bashkëshorti im, fatmirësisht, më përkrahë shumë...

Pa dyshim, dukesh bukur dhe në formë. Si e arrin këtë?

- Eh, nganjëherë më duket vetja "llom", por nganjëherë më pëlqen shumë...

Sidoqoftë, nuk jam duke i kushtuar shumë rëndësi vetes në pamje të jashtme, sepse prioritet e kam punën dhe familjen. Kështu, më mbetet pak kohë që t'i përkushtohem vetes.

Por, as veten nuk e lë anash, sepse profesioni im do edhe pamje të bukur, natyrisht.

Ç'kërkesa kanë më shpesh fëmijët tu?

- Nuk kanë kërkesa të shumta. Më shumë kanë energji pozitive, të shoqëruar me buzëqeshje...

Në anën tjetër, fëmijët janë pacientët e mi më të mirë në klinikë. Fëmijët janë, thjesht, dashuri e jetës...

Ç'risi do të ketë në klinikën Tuaj?

- Po vazhdojmë të punojmë, si gjithmonë, me intensitet të lartë, duke ofruar shërbimet më të mira dentare, për çka edhe njihet "Zak Clinic"...

Po planet profesionale në të ardhmen?

- Kam shumë plane, e që me kohë do u përkushtohem një nga një...

Ku do të pushoni kësaj vere?

- Në det, pa dyshim. Sepse, pas një pune të gjatë dhe me shumë përkushtim, gjithsecili ka nevojë për pushim...

Çka ka mbetur pa u thënë?

- U tha shumëçka, por jo edhe të gjitha. Të pathënat i përmendim në ndonjë intervistë tjetër. Megjithatë, ju falemindërit shumë!

Nderim Neziri

Edhe sa ditë martohet **Edita Sopjani?**



Edita Sopjanit i erdhi koha të bëjë plane për ditën e martesës, edhe atë pa e quar gjatë. Ajo bëri me dije se dasma do të mbahet në Korrik dhe do të martohet me të fejuarin, e që është në lidhje qe dy vjet.

“Njohja me të fejuarin tim, Përparimin, ka qenë krejt rastësisht. Momenti kur u takuam me njëritjetrin ka qenë ajo shkëndija që thua ky qenka i duhuri...”

Por, është interesante se familjet tona njiheshin më herët”, thotë Edita.

Edita, si këngëtare e njohur, prej kohësh është shkëputur nga zhanri me të cilin u bë e famshme, për t’iu përkushtuar muzikës popullore.

Dhe, për këtë gjë thotë: “Duke u rritur në një familje ku ka qenë prezent gjithmonë muzika, sidomos popullorja, kam vendosur të orientohehem, kryesisht, te ky lloj i muzikës. Fillova me dasma, por erdhi vullkani i pandemisë dhe na çrregulloi...”

Por, besoj se vera e sivjetme do të jetë ndryshe dhe të vazhdojmë punën si duhet”.

Por, a do të këndojë Edita edhe në dasmën e vet, pritet të shihet...

Melinda Ademi, e para në listën e këngëtareve favorite

Për të gjithë ata që nuk e dinë, Melinda Ademi e ka nisur karrierën e saj në moshën 16 vjeçe në shoun e famshëm "American Idol". Në performancën e parë ajo performoi përballë artistëve ndërkombëtarë, ndër ta edhe Xhenifer Lopez, e cila i dha një "po" të madhe. Por, fatkeqësisht, nuk arriti të shkonte shumë larg, aq sa për të prekur, së paku, gjysmëfinalen. Melinda më pas bëri një hap tjetër, duke u zhvendosur në Kosovë

për një karrierë të bujshme muzikore. Por, fillimi edhe në Kosovë ishte sfidues. Mirëpo, më në fund, ia doli që të bëjë për vete publikun e gjerë, që sot e ndjekë me simpati dhe kureshtje. Kujtojmë se pas një mungese të gjatë në muzikë për shkaqe personale, Melinda Ademi u rikthye sërish me një projekt të ri. "Qa din ti" është hiti që po dëgjohej me të madhe dhe që i dha këngëtares pozitën e parë në listën e këngëtareve favorite.



A photograph of Alban Ramosaj performing on stage. He is wearing a black long-sleeved shirt and black pants, holding a microphone and singing passionately. The background is a warm, orange-toned stage set.

Alban Ramosaj - urgani i skenës shqiptare

Në gjysmëfinalen e festivalit “Kënga Magjike, Alban Ramosaj la shpirtin në skenë, duke mahnitur publikun. Performanca e tij ishte tregues i qartë se Albani do të shkonte larg në këtë festival. Këngëtari llogaritej të ishte favorit dhe kështu doli, pasi në finalen e madhe të festivalit, ai doli të jetë më i votuari nga kolegët, po ashtu, edhe nga juria profesionale. “Thikat e mija”, interpretuar nga këngëtari kosovar, u shpall fitues me meritë të plotë.. Ai tha se këtë arritje ia dedikon nënës së tij, që ishte deklaratë shumë e përzemërt menjëherë pasi ai u shpall fitues.

Si e mundi diabetin Rina Balaj?

Këngëtarja dhe reperja Rina Balaj është njëra ndër fytyrat publike të përfolura në vend, sa shkak i bujës që ka bërë në fillimet e karrierës së saj, të problemeve që ka pasur me disa prej vajza të estradës, e shumëçka tjetër... Ndërkaq, Rina viteve të fundit është fokusuar vetëm në karrierën e saj, duke mos i trazuar më ujërat në estradë. Dhe, këtë e ka bërë të ditur vetë këngëtarja, duke thënë se tanimë është duke iu përkushtuar vetëm karrierës dhe se asgjë tjetër nuk është me rëndësi.

“Bad Rosita” është hiti i fundit i Rinës, këngë kjo që po dëgjohet me ëndje.

Mirëpo, këngëtarja nga Istogu, para një kohe është përballur me sëmundjen e diabetit, e të cilën e ka tejkaluar me aktivitetit fizik.

Sa është e fuqishme dashuria e VIP-ave tanë?

Dashurinë e vërtetë nuk e zbehë kalimi i viteve. Përkundrazi, e bënë edhe më të fuqishme atë...



LYRICAL SON DHE GRESA

Në 7-vjetorin e martesës, Lyrical Son i dedikoi të shoqes fjalët e bukura të dashurisë: "Urime 7 vite martesë zemër! Ishalla do Zoti e jemi me shëndet dhe gjithmonë bashkë. Të dua!"



GRANIT XHAKA DHE LEONITA

Në përvjetorin e gjashtë, Granit Xhaka zgjodhi fjalët më të sinqerta për të shoqen, Leonitën: "Përvjetori jonë është më i rëndësishëm se çdo ditë. Unë festoj për ty, dashuria ime, dhe të dua në çdo moment. Ndihem shumë me fat që të kam dhe uroj që shpirti yt të jetë gjithë jetën i mbushur me lumturi! Gëzuar përvjetorin! Të dua zemra jem".

LABINOT GASHI DHE QËNDRESA

Në përvjetorin e martesës, Labinot Gashi uron të shoqen me fjalët: "Zemër, sot ne festojmë përvjetorin e martesës sonë. Këtë vit përvjetorin e kemi edhe më të bukur me Rroan tonë. Përzgjedha këtë foto, sepse simbolizon dhuratën më të çmuar që m'ke fal. Ju dua pa fund".



ANDRRA DHE SINAN HOXHA

Në 6-vjetorin e martesës, Andrra i bëri dedikimin më të veçantë Sinanit: "Nëse e di çfarë është dashuria, e di prej teje. Gëzuar përvjetorin dashuri!"



... tash

Dikur kërkonte azil, tash artist i kërkuar

Këngëtari i famshëm, Sinan Hoxha, është një ndër artistët më të suksesshëm shqiptarë. Por, ndonëse sot jeton një jetë luksi, adoleshenca dhe rinia e tij nuk kanë qenë aspak të mira...

Si i ri, Sinan Hoxha, synim kishte ikjen nga Shqipëria dhe strehimin në Maqedoni a Greqi. Dhe, në vitin 1989 u kapë në orvatje për t'u arratisur për në Jugosllavi, në Kërçisht të Dibrës dhe u dërgua në burg. Atje menjëherë i dhanë epitetin e të indoktruarit nga propaganda e shteteve përreth Shqipërisë, konkretisht nga Maqedonia dhe Greqia.

"I nxitur nga propaganda borgjeze, duke ndjekur televizionet dhe radiot e stacioneve të huaja, i lindi ideja për t'u arratisur në Jugosllavi, duke u gënjyer

se "atje jetohej mirë", "ka vetura e motoçikleta me bollëk", "do bredhë kah të dojë", "do bëjë si do vetë" etj., thuhet në raportin e atëhershëm të Prokurorisë së Shtetit Shqiptar.

Në atë kohë Sinan Hoxha ishte 14 vjeç dhe nuk u dënua me gjyq për të rriturit, por me gjyqin e shkollës në formën e demaskimit.

NJË VIT MË VONË U ARRATIS NË GREQI

"Në vitet 90 kufiri veç filloi të mos mbikëqyrej si në kohën e komunizmit, kurse greku të priste mirë.


Isha 15 vjeç dhe, duke kaluar male e male, kodra e kodra, nëpër baltë e shi dhe pa bukë, kalova në Greqi.

Një familje më pa atje dhe më pranoi në shtëpinë e tyre, që të laja vetura.

Më shumë më mori për gjynah se isha i ri", tregon këngëtari i njohur.

E NISI ME FURRË BUKE, U BË ARTIST I FAMSHËM

Mirëpo, emigrimi në Greqi rezultoi të ishte një ndihmesë e madhe për të, pasi me paratë e kursyera hapi biznes në Shqipëri. Së pari, hapi një



Sinan Hoxha në rini

furrë buke, pas një tjetër e kështu me radhë...

Por, arritjen më të madhe e bëri në muzikë, sa që tash është shumë i kërkuar në mbrëmje të ndryshme muzikore dhe kudo ku ka shqiptarë. E, kush mund ta harrojë duetin e tij me Shyhrete Behlulin me titull "Knoma kangën"?

Inxhinierja Albulena Dakaj, një histori e vërtetë suksesi në Suedi

Jemi mësuar të dëgjojmë histori suksesi të vajzave tona në botën e muzikës, filmit e modelimit. Por, sikur kemi harruar të hulumtojmë, t'i gjejmë e prezantojmë historitë briljante të femrave tona të jashtëzakonshme në fusha të tjera...

Në këtë numër të "Kosovares", për ju, tregimi i Albulena Dakaj, inxhinierie e suksesshme në Suedi, e cila ka investuar vite me radhë në ngritjen e saj profesionale.

Albulena punon fuqishëm në një nga profesionet më sfiduese dhe ia del të ketë shumë projekte të rëndësishme...

Albulena Dakaj, a mund të njihemi më mirë me ju? Na thoni pak më shumë për veten?

- Jam 32 vjeçe, jetoj në Suedi, ku edhe jam rritur. Prindërit e mi erdhën në Suedi kur isha vetëm 8 muajsh. Si fëmijë më pëlqente të shkoja në shkollë dhe të mësoja. Gjithmonë kam dashur të arrij një karrierë të mirë dhe më pëlqen të punoj. Profesionit tim i jam përkushtuar shumë, andaj e kaloj në punë një pjesë të madhe të jetës sime të përditshme.

Ku jeni shkolluar dhe si ka ecur procesi i shkollimit dhe i ngritjes suaj?

- Kam studiuar për Master of Science in Engineering në LTH, Faculty of engineering, Lund University. Ka qenë një kohë e mundimshme, me ditë të gjata e me ligjërata. Por, gjithashtu, ka qenë edhe një periudhë arsimore me leksione praktike dhe teorike. Dhe, përveçse kam fituar shumë njohuri në këtë fushë gjatë studimeve, kam fituar, gjithashtu, edhe një rrjet të madh të kontakteve.

Jeni inxhinierie. Pse e zgjodhët këtë profesion?

- Si fëmijë, gjithmonë kam qenë e interesuar në infrastrukturë dhe ndërtim. Ndërtimi dhe zhvillimi

i shoqërive të qëndrueshme për gjeneratën tjetër është diçka që më tërheqë, ku njerëzit mund të banojnë, punojnë dhe jetojnë.

Tash, a mendon se ke bërë zgjedhjen e duhur profesionale?

- Po, kam bërë zgjedhjen e duhur. Është profesion sfidues dhe zhvillues. Përveç kësaj, është kënaqësi të punosh me një profesion që të arrish diçka që mbetet për një kohë të gjatë...

Cili është suksesi yt më i madh në jetën profesionale si inxhinierie?

- Kam pasur projekte të ndryshme. Nuk është lehtë ta matësh suksesin në këtë profesion. Sukses për mua është të ndërtoj me cilësi të lartë dhe me kosto të ulët e me zero aksidente gjatë ndërtimit. Punonjësit duhet të punojnë në një vend pune të mirë dhe të sigurt. E, unë kam pasur gjithmonë sukses në projektet që kam drejtuar.

Megjithatë, inxhinieria është profesion sfidues apo jo?

- Ka shumë detaje që duhet të adresohen në të njëjtën kohë. Duhet të jesh rezistent ndaj stresit, për të përballuar një jetë të përditshme si inxhinierie, sepse asnjë ditë nuk është e njëjtë.



Dimë se jeni menaxhere e projekteve. Më konkretisht?

- Kam tetë vjet që punoj në këtë profesion. Pesë vjetët e parë kam punuar në ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturën, në një nga kompanitë më të mëdha të rrugëve në Suedi, "Svevia", në qytetin Malmo.

E, qe tre vjet punoj në një kompani ndërtimi të quajtur "JSB Construction AB", po ashtu, në Malmo, ku ndërtojmë ndërtesa banimi, shkolla, ambiente të mëdha me depo të ftohtë e hapësirë për zyre sipër.

Mund të na flisni për projektin në të cilin punoni aktualisht?

- Jam e angazhuar në tre projekte të ndryshme, në të njëjtën kohë: Një ndërtesë banimi shtatëkatëshe; një depo logjistike me shumë ambiente zyresh sipër; si dhe me një projekt në një burg, ku para se të më lejohej të merrja detyrën, kërkohej miratimi i Policisë së Sigurisë (SÄPO) dhe një marrëveshje konfidencialiteti, e nënshkruar përpara se të fillonte ndërtimi në institucion.

Një femër që punon si ti, inxhinierë, ka më shumë vështirësi, lehtësi, apo gjinia nuk është përcaktues i njëjës apo tjetrës?

- Pa dyshim, të jesh inxhinierë nuk është lehtë. Sepse, duhet të jesh femër e durueshme për të përballuar profesionin.

Je shkolluar e avancuar në një vend shumë të avancuar në çdo aspekt, krahasuar me Kosovën. Nëse do të ishe në Kosovë, a do ia dilje ta kishe këtë sukses që ke në Suedi?

- Dëshira për t'u bërë inxhinierë do ishte e njëjtë. Por, nuk di nëse do kisha mundësinë për të studiuar dhe për ta avancuar pro-

fesionin e inxhinieres në Kosovë...

Sa orë gjatë ditës punon dhe a ke pasur ndonjë moment kur je lodhur shumë nga angazhimi dhe e ke ndierë veten keq?

- Punoj 8 orë në ditë, nga e hëna deri të premten. Natyrisht, ka ndodhur të jem lodhur, por asnjëherë nuk jam penduar pse e kam zgjedhur profesionin e inxhinieres...

A ke menduar, ndonjëherë, përvojën tënde ta sjellësh në Kosovë?

- Dëshira ime është të kontribuoj me përvojën time si inxhinierë edhe në Kosovë, po t'më jepej mundësia. Dhe, shpresoj në një gjë të tillë...

A vini shpesh në Kosovë?

- Po, shpesh. Së paku 3-4 herë në vit. Sepse, edhe pse jam rritur në Suedi, mungesa e atdheut tim është jashtëzakonisht e madhe.

Cila është jeta juaj jashtë profesionit?

- Kohën time të lirë më pëlqen ta kaloj me prindër, motra, vëllezër dhe shoqëri. Bëj jetë aktive dhe përpiqem të qëndroj në formë. Por, gjithash-tu, e vlerësoj paqen dhe qetësinë me lexim dhe gatim.

Ke hobi, pasion?

- Më pëlqejnë shumë gjëra të ndryshme: udhëtimet antike, natyra dhe kultura.

Mesazhi juaj?

- Kam një mesazh për të gjitha vajzat që duan të bëhen inxhinierë dhe që ngurrojnë t'i realizojnë ëndrrat e tyre: Mos kini frikë, besoni në veten tuaj dhe ndiqni qëllimin tuaj!

Ju faleminderit për intervistë!

- Faleminderit nga Ju!

N. Neziri

Edhe kërkon të ndahet nga unë, edhe do fëmijë me mua!



Jam Vesa, 31-vjeçare, nga Ferizaj. Ka kohë që me burrë nuk kemi marrëdhënie të mirë. Ai kërkon divorc, por këmbëngulë të vazhdojmë të bëjmë seks e ta kemi një fëmijë!

Me tim burrë njihemi që nga fëmijëria. Dhe, ta njohësh partnerin që në fëmijëri, ka plot anë të mira, por edhe të këqija.

“Ne u dashuruam që në fëmijëri dhe filluam të takoheshim kur unë isha 15 vjeçe. Tani jam 33 vjeçe, e martuar qe dhjetë vjet.

Ai punon në një firmë, e cila nuk e respekton orarin e punës, por i ndalë punëtorët edhe pas orarit kur kanë punë. Kjo më nevrkostete dhe më nevrkoste gjithmonë, sepse unë e bëj gati drekën e ai askund...

Para dy muajsh, një natë, para se të flinim, më tha: “Dua të divorcohem”. Pra, kërkoi të divorcohem pas dhjetë

vjet martesë dhe pa ndonjë arsye të veçantë, përveç disa zënkave të vogla bashkëshortore që i kemi pasur herë pas herë.

DERISA TË DIVORCOHEMI TË BËJMË SEKS!

Por, problemi tjetër është se ai, derisa të divorcohem, kërkon të vazhdojmë me marrëdhënie seksuale, sikur asgjë nuk po ndodhë ndërmjet nesh!

Dhe, një ditë, teksa ai ishte në punë, unë ia paketova të gjitha rrobat dhe gjësendet tjera dhe ia dërgova në garazh.

Kur erdhi në mbrëmje, pasi hyri brenda dhe nisi t’i ndërroj rrobat, u step kur pa se ormani i tij ishte i zbrazët...

I thash: “Shko në garazh, merri rrobat tua të paketuara dhe nga sot fle ku të duash, vetëm me mua jo!”.

Mbet i stepur, sikur nuk e priste një gjë të tillë... Dhe, pas një kohe, i tretur në mendime, doli nga dhoma dhe tha se sonte do shkoj te një shok i tij, por nesërmbrema do vij sërish...

“Jo, ti më këtu kurrë!”, i thash.

Të nesërmen erdhi, por jo edhe të fle

këtu, por t’i marrë gjësendet për rrojë, që i kishte në banjë...

Dhe, para se të largohej, më tha se do të vij herë pas herë që të bëjmë seks, bile derisa të mos divorcohem...

E, unë ia preva shkurt: “Kurrë më!”.


TA BËJMË NJË FËMIJË BASHKË, SEPSE KEMI PASUR SEKS TË MIRË!

Pas një kohe më thirri në telefon dhe më tha se kishte nevojë të flisnim bashkë për një problem me rëndësi. I thash, thuaj çka ke me më thënë dhe mos më thirr më...

“Dua ta bëjmë një fëmijë bashkë, sepse jeta jonë seksuale ka qenë gjithmonë e përkryer!”, më tha dhe më luti të mendoj për këtë gjë.

“A, pse jeta jonë seksuale ka qenë e përkryer dëshiron të kemi fëmijë bashkë, a?!”, ia ktheva me zë të lartë dhe menjëherë ia mbylla telefonin. Dhe, nuk dija: të qeshja a të qaja. Pranova, duke menduar marrëzisht se sapo të fillonim të jemi bashkë, ai do të ndryshojë mendimin për divorcin tonë.

Vesa, Ferizaj



- ★ Che Bar Lounge 044 343 734
 - ★ Che Bar Marigona Residence 045 77 20 20
 - ★ Che Fox 044561562
 - ★ Che Bar Prizren 045774040
- www.chebargroup.org
 /chebargroup



Një dreq ka hyrë ndërmjet meje dhe vjehrrës!

Kam problem me vjehrrën time dhe s'po di ç'të bëj. Të ndahem nga burri shkaku i saj nuk ia vlen. E, si do jetë jeta ime në të ardhmen, vetëm Zoti e di...

Jam vajzë, teze, kunatë, motër dhe nuse, nënë ende jo. Nuk e di se si do të reagoj kur të kem fëmijë, por nuk mendoj se do të reagoj ashpër ndaj vjehrrës si disa nuse që njoh. Si vajzë kam bërë jetë normale, kam pasur probleme me nënën time, madje mjaft, sepse kemi karaktere të kundërta, por

asnjëherë nuk mbajmë inati ndaj njëra-tjetrës. Menjëherë kalon, sepse ajo është nënë dhe gjithmonë tërhiqet...

VJEHRRRA ËSHTË E DIVORCUAR DHE MË VËRSULET MUA!

Vjehrra ime është e divorcuar, por ka kohë që është lidhur me një burrë nga fshati. Është njeri i mirë, por është shumë me ide të vjetra dhe fanatik. Një ditë arriti kulmin e më tha: "Je bërë si lopë!". Edhe pse mund të ishte në kuadrin e një shakaje, unë i tregova burrit tim dhe ai i tha atë që duhet t'i thoshte. Kështu, me të më nuk flas dhe as që e dëgjoj se ç'thotë... Por, me kunatën (motrën e burrit) kaloj mirë, edhe pse ajo jeton në një qytet tjetër. Natyrisht, kemi

ndonjë keqkuptim, por kemi arritur të bëhemi mike të mira. Ajo, përveçse është motra e burrit tim, është edhe si një shoqe për mua. Por, mua presion më bën vazhdimisht vjehrra dhe nuk më lë rehat me dashnorin e saj, i cili shpesh vjen te ne, në shtëpinë tonë...

PO TË NDAHEM NGA BURRI DO TË KËNAQËJ VJEHRRRA IME!

Dhe, sado që më nevrkos me sjelljet e saj të këqija, shpeshherë i them vetes se nuk do e lë burrin e t'ia plotësoj dëshirën vjehrrës sime, e cila do të kënaqej po të largohesha nga shtëpia e tyre... Andaj, një gjë të tillë nuk do ta bëj kurrë...

Florentina



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE



Pse gratë po i rrahin burrat?

*Qëkur gratë fil-
luan të trajno-
heshin pas lufte
për të drejtat e
veta, xha Cani,
i mëhallës sime,
nuk dëshironte
të jetonte më.
Sepse, e paran-
diente se çka do
të ndodhte me
burrat...*

Ka ikur koha kur gratë nuk ndiheshin të gjalla. Në fakt, a ka qenë kështu apo jo, nuk është krejt e vërtetë, por para se të flasim për këtë storie, duhet të tregoj diçka për axhën Hasan, plak i mëhallës sime.

Axha Hasan, e që ne e quanim Can, ka qenë merakli i femrave. I kuq si molla në fytyrë, ka jetuar 113 vjet.

MERAKLIU QË JETONTE NGA DASHURIA

Axha Can shpesh na tregonte se si ia dilte, kur e porositnin prindërit ta rrihte gruan...

“Në mbrëmje, kur kthehesha nga punët në ara, baba shpesh më thoshte se nusja ka bërë faj dhe duhej ta rrihja... Një ditë, gruaja ime ishte zgjuar pak më vonë se zakonisht dhe nëna ishte ankuar te baba se nusja po zgjohet vonë...

Ishte bërë zhurmë. Gruaja erdhi shpejt në dhomë, sepse ende qëndroja shtirë në shtrat dhe më tregoi se i kishin bërtitur pse nuk po zgjohet herët... Dhe, sipas prindërve të mi, duhej ta rrihja gruan... Por, ec e rrihe gruan për hiçgjë?!

I thash: Mos ke dert, do merrem vesh me ta që të të lënë të qetë përgjithmonë... Kërpeshin po e lë këtu dhe kur t’me thonë se duhet të të rrah se ke bërë faj, e marr kërpeshin dhe u bie jorganëve...

Dhe, në një ditë, kur edhe u ankuan në gruan time, i thash nuses të vij në dhomë. E mora kërpeshin dhe fillova t’u mëshoj jorganëve dhe të bërtas me zë të lartë, sepse e dija se ata do të gëzohen kur t’me dëgjojnë duke bërtitur.

Bam-bum, bam-bum, u mëshoja jor-

ganëve, derisa babai bërtiti nga jashtë: "Boll se e mbyte gruan, o dreq!".

Në çast dola jashtë me hidhërim, e ajo mbeti në dhomë, kinse nuk mund të rrinte në këmbë nga rrahja...

Nëna, posa më pa, më tha: "A je tranu a çka ke tjetër?! Si rrihet nusja ashtu?!".

Nëna, në atë moment, u nis për në dhomën time që ta ndihmonte nusen, por i thash jo, sepse pastaj do lazdrohej se po e marrim me të mirë...", shpesh tregonte xha Cani, në ndeja të ndryshme në odë burrash.

PLAKA, PARA SE TË VDISJE, IA KËRKON NUSES HALLALLIN!

Nëna e Canit kishte vuajtur shumë para se të vdiste. Nuk i dilte shpirti pa ia kërkuar hallallin nuses.

"Kur nëna u sëmurë, i kërkoi një gotë ujë nuses. E, kur ajo ia ofroi, i tha:

"Nuse, a ma bën hallall se shpesh e kam shti djalin me të rrahë dhe s'po më del shpirti pa ma bërë hallall?! Edhe ëndrra më ka treguar se duhet ta kërkoj hallallin!".

"Po, nënë, qysh nuk ta bëj hallall, se kurrë një kërpesh se kam hangar prej Canit!".

"Po, bijë, e di që nuk do me e bë të madhe, por hallalli ma lehtëson vdekjen!", ia kthen ajo.

PSE PAS LUFTE GRATË TONA U TRIMËRUAN?

Dhe, pas ardhjes së KFOR-it në Kosovë, nisën do trajnime nëpër fshatra dhe shkollat u mbushën me gra. Ishin trajnime që gratë pa frikë t'i denonconin burrat nëse i rrihnin...

E kishte pyetur axha Cani rejen se çka po u thonë në shkollë, në ato trajnime...

"Po na mësojnë qysh me i paraqit në polici burrat nëse na rrahin!", ia kthen reja.

Dhe, prej asaj dite, axha Cani më

nuk e donte jetën.

Jo pse duhej të rriheshin gratë, por pse gratë, kur duan t'i realizojnë qëllimet e veta, të denoncojnë në polici edhe kur nuk ke bërë asgjë...

Ashtu edhe ndodhi. I pari që u mor atëbotë në burg për kanosje të jetës së gruas, ishte 50-vjeçari, T. M., fqinj imi. Ai kishte qenë njëfarë komandanti në luftë. Dhe, me mendjen e komandantit, e mori veten si dikush që nuk kishte të ndalur dhe as frikë prej askujt. Nja dy shpulla ia kishte dhënë gruas pas 30 vjet jete të përbashkët dhe ajo shkon në polici. Policia erdhi, por nuk e mori, meqë e njihnin si komandant. Por, ajo nuk u ndal dhe e denoncoi në KFOR. E morën ushtarët KFOR-it dhe e dërguan në burg. I mbajti rrafsh gjashtë muaj burg.

PSE TASH GRATË PO I RRAHIN BURRAT?

Tash kanë ndryshuar gjërat. Ditën e Fitër Bajramit e pash një lajm në një portal tonin me titull: "Gruaja e bën për spital burrin në Ditën e Bajramit!".

Të nesërmen lexoj shkrimin: "Gruaja e rrahu burrin në Fushë-Kosovë".

Pastaj shkrimi: "Gruaja rrah ish-burrin në Obiliq, e bën për spital".

Një shkrim tjetër: "Gruaja në Mitrovicë rrah burrin me mjet të fortë, e bën për spital!", etj.

Shtrohet pyetja: Çka po ndodhë me gratë tona në Kosovë?

Dhe, menjëherë m'u kujtua axha Cani, që thoshte se gruan s'e kam rrah kurrë, por do të vjen koha që gratë do i rrahin burrat.

Dhe, ajo kohë erdhi...

Por, ndoshta, duhet një analizë psikologjike pse gratë po i rrahin burrat...

Megjithatë, pa hyrë në hollësi, mendoj se bazike është gjendja e rëndë sociale dhe familjare. Nuk janë gjithmonë në pyetje dëshirat dhe qejfet, por skamja dhe varfëria.

Por, edhe pandemia (mbyllja në shtëpi) e ka bërë të veten...

Safet Krivaça



Për libër të Ginisit...

Cili plak në Kosovë i ka pasur 200-300 femra?

Një burrë i moshuar nga Kosova, në një emision televiziv në DTV, thotë se i ka pasur 200 deri në 300 të dashura...

Plaku, i qetë, i veshur me veshje kombëtare dhe me plis në kokë, tregon se i ka pasur 200-300 femra gjatë jetës së tij, e që, sipas tij, më shumë femra ka pasur vetëm aktori i njohur Faruk Begolli.

Madje, ai thotë se femrat i ka zgjedhur ato që kishin trup të mirë, belholla, si balerina...

"Femrat i kam dashtë shumë, si Faruk Begolli. I kam pas 200-300 femra, por Faruku ka pas më shumë. I kam zgjedh femrat me trup të mirë, si balerina", thotë ai.

Qesharake, por e vërtetë...

Edhe këtë e bëjnë emigrantët kosovarë: deklarohen homoseksualë që të fitojnë azilin në Francë ose e “ndërrrojnë” fenë për të fituar azilin!

Kosovarët paraqiten “homoseksualë” që ta fitojnë azilin!

Kosovarët deklarohen si homoseksualë për të fituar azilin në Francë e Gjermani. Janë këto dallaveret e azilkërkuessve kosovarë për të fituar “azilin” në Zvicër, Gjermani, Francë, Belgjikë apo vende të tjera të BE-së.

Emigrantët, sikur edhe shumë shqiptarë që po ikin nga Kosova, po i përdorin të gjitha mënyrat që të



mbesin në shtetet ku kanë shkuar, vetëm e vetëm që të mos kthehen mbrapa.

Madje, ka edhe të tillë që deklarohen si “homoseksualë” dhe se janë të rrezikuar në rast se do të kthehen në Kosovë! Pra, emigrantët konvertohen në “pedera” për ta fituar më lehtë azilin në vendet e BE-së!

Sipas të dhënave nga shtetet e Perëndimit, të tillë janë deklaruar 500 sosh vetëm nga Kosova dhe Shqipëria. Por, duket se ky konvertim nuk është i sinqertë, është fals... Sidoqoftë, një mori njerëzish bëjnë çmos, madje bëhen edhe homoseksualë vetëm e vetëm që të mbesin në shtetet e Perëndimit!

D. Haxhaj

Në desh mos besoni...



Është vetëm 21 vjeçe dhe i ka pesë burra, njëkohësisht, të cilët janë vëllezër...

Rajo Verma, induse, 21 vjeçe, jeton në një kasolle me një dhomë. Ajo ka treguar se fle çdo natë me njërin nga vëllezërit. Dhe, kështu me radhë... Ajo nuk ka asnjë ide se cili është babai i

Në cilin vend me një nuse flenë 5 vëllezër?

fëmijës së saj. Thotë se është në pozitë të vështirë, sepse nuk e favorizon asnjërin prej tyre, por me secilin ka marrëdhënie seksuale.

Gudu, 21 vjeçe, i pari i cili e bëri nuse Rajo Vermën, thotë: “Të pesë vëllezërit kemi marrëdhënie seksuale me të dhe asnjëri nuk e xhelozojmë tjetrin. Jemi një familje e lumtur”.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksesit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?!

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbërë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degjenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjezik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurrja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjavin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullet trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

A ka fat nga dhëmbi i ujkut?

E kishte fituar një tufë dele, falë një fotografie që ia kishte bërë një kalimtar rasti. Objektivi i fotografisë kishte fokusuar lotët e një fëmije, i cili qante pranë tufës së deleve, e që ia kishte prerë ujku në fytyrë. Ajo kope delesh ishte e tërë pasuria e tij, që ia kishin lënë prindërit e varfër atij dhe binjakut tjetër, i cili kishte vdekur qëkur ishte në djep.

Prindërit ishin kujdesur që të dy fëmijët binjakë, t'i rrisin me ato mundësi që kishin. Por, fati s'kishte qenë në anën e tyre. Në shtëpinë e tyre kishte dominuar skamja e paskajshme...

Ndihma e vetme ishte ajo e fshatit, kur ua patën falur nga një kokë dele për ta ngjallur familjen.

Për fat të keq, pas një kohe, njëri nga binjakët kishte vdekur. E, vdekja e binjakut kishte pllakosur shpirtrat e prindërve dhe, nga pikëllimi, edhe babai kishte vdekur, një pasdite në krye të vitit.

Dhe, vdekjet e njëpasnjëshme kishin filluar të lënë frikë te nëna e tyre, e që e priste se do ta merrte shpejt nga jeta.

SI E MORI ERA BINJAKUN SI TË ISHTE LETËR?!

Jetonin në një shtëpi të vjetër. I kishte vetëm dy dhoma. Në kor-

ridorin e saj ishin dy rrotë qerreje druri. Shtëpia ishte e lyster me baltë, përzier me kashtë.

Pas një kohe, një stuhi e fuqishme e kishte hedhur në zabel një pjesë kulmi. Në atë moment të keq, binjaku kishte qëlluar në oborr dhe era e kishte qar disa metra larg, e që kishte mbetur i shtypur në drurin e koshit të misrit.

Në krye të vitit kishte vdekur edhe e ëma. Dje, parandjenja se do të vdiste edhe ai, ishte shumë e pranishme, edhe pse ai ende ishte fëmijë, kurse pasuria e tij e vetme ishin gjashtë krerë dele.

PSE KISHTE FRIKË SE NUK DO TË RRITEJ?

"Nuk di as vetë si jam rritur te fqinjët e mi?! Nuk e di kohën kur e braktisa shtëpinë time, sepse isha i vogël. Kushdo që më shihte,

kujdesej për mua.

Gruaja e fqinjët, që u bë nëna ime e dytë, e kishte një djalë, vetëm pak muaj më i ri se unë. Dhe, çka i jepte për të ngrënë, më jepte edhe mua...

Kur i bëra tetë vjet, disi më lindën shumë dëshira. Por, më e rëndësishmja ishte si të ngopesha mirë bukë...

Ndoshta, fjalët e njerëzve se ime hallë jetonte në Turqi, ma shtuan dëshirën ta njihja, ta shihja...

Por, në mend gjithnjë e më shumë më shtohet dëshira ta bëja një kasolle timen, qoftë edhe prej fijeve të thekrës, që aso kohe me to gratë i bënin lyftrat për lidhjen e duajve në ara.

Por, mosha ime ishte e pamjaf-tueshme që ta bëja strehën time, sepse ende isha fëmijë, edhe pse, netëve të gjata pa gjumë, mendoja si të bëhesha i rritur dhe të largohesha nga shtëpia e fqinjëve, kurse ditën më merre gjumi duke i kullotur delet...

ARDHJA E HALLËS NGA TURQIA...

Një natë, posa më kishte zënë gjumi, më kishte ardhur në ëndërr një grua e gjakut të prindërve. Nuk kisha ide se kush ishte, vetëm e dija se e doja shumë...

Natën, në gjumë, doja ta përqafoja atë grua, për të përjetuar afërsinë e gjakut, por dora më mbeti e zgjatur kur ndjeva se kisha prekur dikë, por jo edhe hallën...

Kur më doli gjumi u zhgënjeva pse nuk zgjati ëndrra edhe pak, që ta përjetoja ngrohtësinë e dikujt që e dëshiroja.

Dhe, në mëngjesin e asaj dite, teksa po i lëshoja delet, një grua me një burrë u shfaqën para shtëpisë ku jetoja.

Ajo, me lot në sy, m'u afrua dhe, pasi më shikoi gjatë, më përqafoi... Burri, që ishte me të, i tha mos e kishin gabuar shtëpinë, por ajo ia bëri me dije se ishte në shtëpinë dhe vendin e duhur.



Shtanga. Nuk kisha forcë t'i pyesja kush ishin e nga vinin...

"Ky është djali", i tha gruaja burrit. Dhe, sërish më përqafoi shumë e shumë...

"Oh, të pastë halla! U bëftë prej teje një katund! A e di kush jam unë?", më tha ajo.

"Jo, nuk po të njoh", i thash.

"Jam halla jote, motra e babait tënd, nga Turqia", ma ktheu ajo.

GËZIMI I PARË

Jo vetëm unë, por edhe fqinjët u gëzuan që ajo, më në fund, u kthye. Dhe, që nga ajo ditë, halla e hapi derën e shtëpisë sonë, e që nuk ishte hapur me vite...

Hapja e derës së shtëpisë ishte gëzimi i parë pas daljes sime nga shtëpia.

E solla në mendje: Përsëri jam në shtëpinë e lindjes, madje edhe me hallën time...

U gëzuan të gjithë, sa për faktin që u liruan prej meje, po aq se isha takuar me hallën, motrën e babait tim.

Pas tri ditësh, kur edhe isha me dele në zabel, si çdo ditë tjetër, më kishte zënë gjumi.

Dhe, kur u zgjova, delet nuk ishin askund. Dola në rrugën që i lidhte tri kodrat, e që ishin më të bukurat e këtyre anëve. Këlyshin e pash të mbytur, e pak përtej tij edhe delet që kishin përfunduar në dhëmbët e ujkut!

Nisa të qaj, të bërtas... U ndjeva i trishtuar... Zot, thash me vete, çka paska ndodhur?!

Dhe, derisa qaja, erdhi një njeri me aparat në dorë dhe i fotografoi delet e vrara nga ujku. Por, një foto e bëri edhe me mua, teksa qaja... Kur u ktheva në shtëpi, i tash hallës se delet kishin përfunduar në dhëmbët e ujkut. Halla nuk e bëri të madhe këtë ndodhi, por më tha se e kemi humbur gjithë familjen e lëre më delet...

FOTOGRAFI QË MA KTHEU BUZËQESHJEN...

Pas dy muajsh, në derën tonë trokiti një njeri. Ishte po ai që më kishte fotografuar. Më tha se e kishte publikuar fotografinë time në shumë revista e gazeta dhe kishte hapur një fond humanitar. Nxori nga çanta një tubë parash dhe m'i lëshoi në dorë!

"Ke para për t'i blerë pesëdhjetë dele!", më tha ai, me një qeshje të lehtë.

GËZIMI I DYTË

Ky, pra, ishte gëzimi i dytë, madje më i kompletuar. Tash, jo vetëm që jemi bërë bashkë unë e halla, por kemi para për t'i blerë jo vetëm delet që m'i preu ujku, por edhe shumë të tjera.

Pra, edhe prej dhëmbit të ujkut paska hajr nga njëherë...

Safet Krivaça

Ç'thonë gratë e ndara nga burrat?

I lutem Zotit që fëmija të mos e ketë fatin tim!



“Po ta dënoja veten me vetëvrasje, pas ndarjes nga burri, nëna ime do të vdesë menjëherë nga pikëllimi. Andaj, do të bëhem e fortë dhe do e kaloj edhe këtë vuajtje që më shkaktoi ndarja nga burri dhe mbetja me vajzën 5 vjeçe”, thotë Ermira, nga Prishtina, grua e ndarë vitin që shkoi nga burri.

Me tim burrë u njoha në vitin e parë të studimeve, para dhjetë vjetësh. Në fillim çdo gjë ishte ideale. Dashuri e përkryer. Mësonin sa mundnim, por edhe kohë për argëtim kishim mjaft. Dhe, në vitin e tretë të studimeve i dashuri im i braktisi studimet dhe iu rrek hapjes së një kafiterie te “Santea”, në qendër të Prishtinës. Thënë të drejtën, nuk më pëlqeu puna e tij, por, meqë dashuroheshim mar-

rëzisht, heshta. Ula kokën mbi libra dhe mësoja, në mënyrë që studimet t'i përfundoja në afat.

Kështu edhe ndodhi. Në fund të vitit edhe diplomova dhe e mora diplomën në fakultetin ekonomik. Një vit më vonë edhe u martuam. Bëmë një dasmë jo të madhe, sepse edhe unë, por edhe i dashuri im, nuk dëshironim të shpenzonim pa nevojë. Kjo më jepte shpresë se burri ishte përqendruar në biznes dhe parane nuk e hidhte pa nevojë...

SHTATZËNIA ERDHI BASH KUR NUK E PRISJA...

Në muajin e dytë të shtatzënisë e kuptova se po bëhesha nënë. Do kalonin edhe 7 muaj dhe unë do bëhesha me fëmijën tim.

Një mbrëmje dëgjova burrin dhe vjehrrën tek flisnin për mua... Nuk ishin fjalë të mira... Ai sikur kishte lëvizur nga pozicioni ynë dhe ishte orientuar dikah tjetër, me gjasë te ndonjë punëtorë e tij në kafeterinë që e mbante... U shqetësova shumë. Nuk dija si ta hapja bisedën me burrë. Frikësohesha se mund të kisha zënka dhe martesë jonë do të shkatërrohej. Andaj, vendosa të heshtja. Dhe, le të dalë ku të dalë...

Dhe, në fund të muajit të nëntë lindi vajzë. Një pëllumbeshë e bu-

kur erdhi në jetë...

Për çudi, gëzimi im ishte shumë i madh, kurse burri nuk hetohej se ishte gëzuar...

SI I KALOVA 4 VJET TË ZEZA ME BURRIN QË E DOJA SHUMË?

Kur vajza veç i bëri dy vjet, im burrë u pa haptas se më nuk e kishte dashurinë që e kishte dikur ndaj meje. Kjo më bëri të ndihesha keq dhe njëmijë e një gjëra më rrinin në mendje.

Dhe, një ditë, i thash troç:

“Shihet qartë se më nuk më do si dikur!”

“Jo”, ma ktheu pa fije turpi.

“Pse?”, i thash.

“Kam rënë në dashuri me një tjetër”, më tha troç, pa i bishtnuar pyetjes aspak.

Në çast, kulmi i banesës më ra mbi kokë. Dhe, mendja më shkoi menjëherë të vajza ime...

Çka do të bëhet me të, e solla në mendje.

Dhe, pas një kohe të gjatë, pas shumë vuajtjeve dhe dhembjeve në shpirt, vendosa ta merrja vajzën dhe të largohesha nga banesa e tij, duke lënë në shtratin e dhomës së fjetjes momentet më të mira të jetës sime, por edhe netët e gjata pa gjumë, qëkur më tha im burrë se nuk më donte më...

Ermira, Prishtinë



MARITIM
RESORT MARINA BAY



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pse nuk kam fat në jetë?

Jam 27-vjeçare, e kam kryer fakultetin, por nuk kam arritur të punësohem askund! A ekziston fati dhe, nëse ekziston, pse unë nuk kam fat?

“Ermira-pranvera”

Përgjigje:

Fati ekziston. Edhe ngjyrat shprehin fat. Kryetarë shtetesh, kryeministra e ministra, zonja e zonjusha janë lojalë ndaj fatit që kërkojnë. E, edhe ti ke fat. Mirëpo, ka njerëz që tërë jetën janë në kërkim të fatit dhe për ta ofruar atë bartin në trup shenja që ata besojnë se sjellin fat. Dikush bart në dorë diçka, dikush në gisht mbanë unazë, e që nuk është vetëm unazë gishti, por unazë me domethënie fati. Dikush bart në qafë zinxhir, dikush byzylyk etj. Ti, konkretisht, nuk je e pafat, por po të vjen fati. Fejohesh në muajin tetor të këtij viti dhe martohesh një vit më pas.

A do të kem bashkim familjar?

Përshëndetje, e nderuara magjistare! Vitin e kaluar, në muajin shtator, jam kthyer nga Suedia. Atje kam qëndruar tetë vjet pa letra. E pata prish kurorën me grua. Gruaja, vajza dhe dy djemtë i kanë fituar letrat. Më 15 shtator 2017 jam kurorëzuar përsëri me grua dhe kam aplikuar për bashkim familjar në Suedi.

A do t'më realizohet dëshira që edhe unë të shkoj atje e të bashkohem me familjen time?

Përgjigje:

Lëvizjet tuaja familjare tregojnë qartë se keni punuar për t'i fituar letrat. E, në Suedi kjo gjë ka krijuar një mosbesim në ju, ashtu që organet e atjeshme janë në hulumtim të rastit tuaj. Megjithatë, ligjërisht ju takon të bëheni bashkë. E drejta juaj është të jetoni si

familje dhe unë shoh se do t'u plotësohet kërkesa.

Pse nuk më duan njerëzit?

Zonja magjistare, të shkruaj nga një vend i vogël evropian. Jam 38-vjeçare, nënë. Jam ndarë nga burri para dy vjetësh. Punoj, i rrisë fëmijët. Por, kam një hall: Të gjithë ikin prej meje! Për çudi, nuk më ofrohet askush, edhe pse unë nuk u bëj keq. E, kjo po më dhemb në shpirt, sepse nuk po kam me kë të shprehë asnjë brengë... Çka të bëj që ta rifitoj rrethin tim?

“Nëna”

Përgjigje:

Ti jeton në një vend të vogël, ku çdo gjë merret vesh shpejt, kuptohet shpejt. Ke pasur lidhje me një person, banor i rrethit tënd dhe kanë dalë fjalë, e që kanë ndikuar në ndarjen tënde bashkëshortore. Etiketa imorale ka bërë që rrethi të të shmanget, por edhe familja e burrit po bën propagandë të madhe që të të largohen njerëzit prej teje. Sugjerimi im është të sillesh mirë me njerëz dhe, kudo që je, të jesh nënë e mirë, edukatore e mirë. E, kur të ndodhë kjo, gjërat do të shihen vetvetiu dhe rrethi yt do të rikthehet përsëri, duke u arsytuar se jeni në rregull...

Pse dashurohem shpejt?

Zonja magjistare, jam vajzë, 33-vjeçare, jetoj në Gjermani. E dua një djalë. Me të shihem shpesh në vendin e punës. Por, unë nuk jam e gatshme për askënd dhe shpesh jam në depresion.

Problemi tjetër është se dashurohem shpejt e nuk mund t'i shkoj deri në fund asnjë mundësie! Kam probleme me veten time dhe nuk jam e sigurt në rrugën që nisi...

Të lutem, çka po ndodh me mua?!

“Heshtja”

Përgjigje:

Ti ke pasur një lidhje dis-avjeçare me një djalë dhe jeni ndarë. Keni pasur ambicie të martoheni, por për shkaqe të tradhtisë jeni ndarë...

Këtu edhe ka rënë disponimi yt ndaj jetës. Shpirti yt fle e pushon vetëm te ai, e që, siç thotë populli, “e ka hequr duvakun tënd”.

Dhe, për të qenë me dikë tjetër duhet kaluar kohë... Tash për tash nuk shoh se je e gatshme për një lidhje të re, sepse truri dhe shpirti duhet të mësohen me një pamje të re, sjellje të re, e që vjen përmes personit që do ta gjesh.

Shoh se keni pak depresion, sepse zor është të mësohesh me dikë tjetër. Por, një fjalë

e urtë thotë: “Koha shëron!” E, depresioni do u kalojë pasi t’u shërojë koha...

A po rrënohet jeta ime?

Zonjë e nderuar, u shkruaj nga Zvicra. Kam lexuar shumë për ty se u ndihmon njerëzve...

Jam 29-vjeçare, e kam një fëmijë nga martesë me ish-burrin. Ai jeton këtu, por nuk kujdeset për fëmijën dhe sillet sikur nuk është fëmija i tij.

Por, e kam një defekt. Ai defekt është bukuria ime që i ofron njerëzit dhe me ta jam shumë e butë. Nuk mund ta refuzoj askënd, qoftë edhe për shoqërim. Para martesë i kam pasur disa lidhje, e që njerëzit kanë luajtur me mua, meqë u kam besuar shumë.

Një kohë, pas ndarjes, kam qenë stabile, por e kam rifilluar jetën sikur para martesë, e që tash jam në disa lidhje e nuk po di çka po bëj...

E di që po bëj keq, por nuk po mund të ikë nga fati dhe jetës që më ka pushuar. Andaj, tamam marr vendim të bëhem stabile, më paraqitet tjetri që nuk mund e refuzoj...

Të lutem, pse kam rënë në këtë gjendje dhe si e sheh jetën time në të ardhmen?

“Leila”

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Përgjigje:

Ty të njej rrethi yt nga të bëmat tua para martesë, sikur tregon edhe vetë. Vendi ku jeton ti është i vogël dhe ke lënë gjurmë në jetën private...

E, ato gjëra, jo që nuk i ka ditur burri yt, por e ka vlarë bukuria jote dhe bindja e tij se herë do kur do të stabilizoheni...

Por, punët nuk kanë shkuar si edhe janë menduar. Tash, e që jeni ndarë, sa herë dilni jashtë shtëpisë, provokimet e rrethit ndaj teje janë të mëdha...

Në fakt, një numër lidhjesh që ke tani, janë lidhje të së kaluarës. Pra, janë rikthyer njerëzit me të cilët je njohur më herët... Dhe, në tërë këtë histori, është diçka tjetër që të ka dhënë inercion për të dalë prej vetes: Ti ke qenë shumë e shkelur prej burrit. Megjithatë, ai të ka njohur deri diku, por prej se jeni ndarë të njuhë edhe më mirë...

Andaj, kthjellu, sepse ende nuk është vonë që ta kontrollosh veten.

Më së miri është ta ndërrosh vendbanimin, sepse e ndërrosh edhe rrethin njerëzor. Ky ndryshim do të të sjellë progres, e që do të jetë shumë i dobishëm.

Si jetoj unë, e braktisura?

Unë, fëmijë i braktisur qe 19 vjet, edhe pse ende nuk e di kë e kam nënë... Sipas të tjerëve, më kanë gjetur në një paketë në oborrin e një xhamie, në shtatorin e vitit 2000.

Përmes këtij rrëfimi dua ta njoh nënën time. Kjo letër i drejtohet asaj që më lindi dhe më la në rrugë...

Nuk dua ta pikëlloj askënd, nuk dëshiroj ta bëjë askënd të vuaj pse unë, fëmija i lënë në rrugë, pa i mbushur 24 orë dritë, mbeta të rritem pa prindër biologjikë, pa ditur se kush ma vuri emrin që e kam.

Tash, kur kjo natë më kalon me lot si kurrë ndonjëherë më parë, është ditëlindja ime e 19-të dhe pyes veten: Çka kisha dashur sonte më së shumti? Përkëdheljet e kujt do m'i shëronin plagët e jetës? Kë do doja sonte në ditëlindjen time të 19-të?

Kuptohet, askënd pos prindërve të mi biologjikë, të cilët kurrë s'i njoha, por që dua shumë t'i njoh, t'i përqafoj... A thua, a janë bashkë a të ndarë? Apo unë isha shkaktari i ndarjes së tyre? Të paktën, do të dëshiroja të di nëse vuajnë për mua, sepse nuk besoj se edhe fëmijët e tjerë të tyre, nëse kanë, posedojnë diçka më shumë se unë... Jo, mua në aspektin shëndetësor asgjë nuk më mungon, jam edhe ashtu më e bukura në lagjen tonë...

SI E KUPTOVA SE JAM FËMIJË I BRAKTISUR?

Për herë të parë e kuptova se isha e braktisur në kohën kur isha e ulur në një karrige të parkut para banesës sonë, e që përballë qëndronin një çift bashkëshortor.

Njëri prej tyre, konkretisht gruaja, më dha komplimente për bukurinë time... E burri i tha se s'ka si të mos jetë e bukur kur është bijë e prindërve të mirë... Por, unë u bëra kinse nuk i dëgjoja.



Ku je, nëna ime, qe 19 vjet?

Mirëpo, nga ajo bisedë kuptova se me mua diçka nuk ishte në rregull. Nuk isha plotësisht e sigurt, por kisha bindjen se kishte diçka të dyshimtë për prindërit e mi...

Andaj, i lutem perëndisë, që, derisa po qaj në këtë dhomë, të qajë edhe nëna për mua dhe t'më kujtoj se jam diku gjallë dhe vetëm kështu do të jem shumë e ngushëlluar me fatin e dhimbshëm, se po qajmë në kohë të njëjtë, për të njëjtin fat. Dhe, sillem e mbështillem, e bindur se herë do kur do e takoj nënën time, që do t'më tregoj cili është babai im, kush janë dajallarët e mi...

E BRAKTISURA NË OBORRIN E XHAMISË – TASH STUDENTE

Sa kam dëshirë t'ia bëj me dije nënës sime se tash jam studente, por edhe punoj në një lokal afarist. Dhe, gjëja më e vështirë për mua qe kur në aplikacionin për punë ishte edhe rubrika që të shkruhej emri i njërit prind. E, unë, në këtë rubrikë vetëm i vura tri pika...

Në punë, kur më pyesin për prindërit e mi, u them se kanë vdekur qëmoti në aksident komunikacioni dhe gati nuk ua mbaj mend as fytyrat...

MË SHKRUAJ NËNË QË TË TAKOHEMI!

"Më shkruaj nënë, të të njoh. Dua ta ndjej dorën tënde të ngrohtë, ashtu si është dora e nënës për fëmijën. Dua ta shoh flokun, syrin, lotin..."

Ti nuk je në lëkurën time dhe nuk e di si ndjehet një fëmijë pa nënë! Më duket se jam si zogu që ka mbetur në therë dhe cicëron ta gjejë nënën e vet, pa ditur se armiqhtë rreth saj mund t'i hidhen në shpinë.

Unë, tash, ndoshta jam e largët për ty, por, duke ditur se kam ndenjur në barkun tënd nëntë muaj, besoj se jam afër zemrës tënde.

Kur shoqes sime, Njomzës, i vdiq nëna tash një vit, ende e përqafoi murin në hyrje të shtëpisë, vend ku ajo ishte mbështetur para se të vdiste.

I thashë Njomzës të mos qante, sepse bile i ka kaluar bukur do vjet me nënën, kurse unë as sot e kësaj dite nuk të njoh...

Por, nuk mund të ankojem, sepse çifti që më ka marrë më ka mbajtur para duarsh... Më kanë rritur në kushte të mira. Ajo që unë e njihja nënë, m'i ledhatonte flokët kur isha në gjumë, m'i ofronte lodrat afër. E, në mëngjes, kur i hapja sytë, pranë ishte ajo, me një buzëqeshje të lehtë dhe magjepsë.

Dhe, e falënderoj perëndinë që më ka marrë një nënë e tillë, e cila, fatkeqësisht, vdiq para një viti, nga Covid...

V. R.



SHERWOOD

Resorts and Hotels

Feel the Legend

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
PRIZE HOTEL**
LARA / ANTALYA



+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr

